

**Covid-19: Adresimi i ndikimit të
dezinformacioneve dhe teorive
konspirative përmes edukimit
mbi median dhe informacionin**

Erlis Çela

COVID-19: ADRESIMI I NDIKIMIT TË DEZINFORMACIONEVE DHE TEORIVE KONSPIRATIVE PËRMES EDUKIMIT MBI MEDIAN DHE INFORMACIONIN

Erlis Çela



Tiranë, 2021



Ky projekt është mundësuar me mbështetjen financiare të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorit, opinioni i shprehur në të nuk është domosdoshmërisht opinion i Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Grupi i punës për këtë botim u drejtua nga
Erlis Çela

Redaktor: Agim Doksani

Faqosja dhe kopertina: Bujar Karoshi

ISBN 978-9928-4695-0-2

Botues:



Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania

Tel./fax: ++ 355 4 2229800

E-mail: info@institutemedia.org

www.institutemedia.org

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	5
Situata e dezinformimit në kontekstin shqiptar	11
Objektivi i studimit dhe metodologjia	16
Origjina dhe përhapja e teorive konspirative	18
Pse njerëzit besojnë në konspiracione dhe lajme të rreme?	23
Teoritë konspirative dhe lajmet e rreme rreth pandemisë	32
Shkalla e përhapjes së konspiracioneve dhe lajmeve të rreme	37
Analiza e diskursit mediatik mbi pandeminë	43
Narrativat mbizotëruese në media	47
Këndvështrime mbi zgjidhjen e problemit	53
Imunizimi i audiencave përmes edukimit mediatik	59
Përfundime dhe rekomandime	62
Literatura	67

Hyrje

Në shumë dimensione jeta jonë dhe zhvillimi i shoqërisë lidhet ngushtësisht me informacionin. Ne jetojmë në një botë ku sigurimi i informacionit të saktë, mbetet një nga sfidat më të mëdha me të cilën përballemi. Informacioni që konsumojmë përbën inputin kryesor në formimin e opinioneve dhe qëndrimeve tona për botën. Qëndrimet që ne formojmë ndikojnë në vendime të rëndësishme për jetën tonë dhe për të ardhmen e komunitetit dhe shoqërisë ku bëjmë pjesë. Pikërisht rëndësia që ka informacioni në jetën e njeriu dhe shoqërisë e ka bërë atë një aset me vlerë të jashtëzakonshme.

Krizat e mëdha globale janë periudha ku rëndësia e informacionit të bazuar në fakte, del qartësisht në pah. Pandemia e COVID-19 e cila nisi të shfaqet në fillim të vitit 2020 dhe që po na shoqëron për afro dy vite, ka kthyer vëmendjen te dukuri si lajmet e rreme dhe teoritë konspirative. Manipulimi i informacionit për interesa nga më të ndryshmet, që nga ato financiare deri tek ato politike dhe gjeo-strategjike, është kthyer në një shqetësim të madh për shëndetin e njerëzve dhe menaxhimin e pandemisë. Kriza bëri që njerëzit në mbarë botën të shfaqnin interes të lartë për lajmet rreth virusit dhe pasojat që ai linte në shëndetin e njeriut.

Interesi dhe kureshtja për të kuptuar më shumë rreth origjinës së virusit, përhapjes së tij, medikamenteve që kuronin sëmundjen, roli i vaksinës dhe çështje të tjera të ngjashme, bënë që audiencat të ishin të ekspozuara ndaj burimeve jo të sigurta të informacionit. Kureshtja e secilit prej nesh, në lidhje pandeminë, e shoqëruar shpesh me ndjenjën e frikës dhe panikut, ka bërë që në shumë raste të biem pre e lajmeve të rreme, konspiracioneve dhe një sërë formash të tjera dezinformimi.

Siç është provuar tashmë, dezinformimi lulëzon në kohë krizash. Aktorë të ndryshëm me qëllime keqdashëse përfitojnë nga konfuzioni, frika dhe paniku i audiencave për përfitime të ndryshme, duke përhapur qëllimisht gënjeshttra dhe komplete dhe nxitur angazhimin midis përdoruesve të mediave sociale. Njëkohësisht, vëmendja e vazhdueshme në shkallë globale për të kuptuar shkencërisht ecurinë e koronavirusit ka krijuar kushte për shpërndarje të gjerë të dezinformatave.

Zhvillimi i teknologjisë, ndër të tjera ka prodhuar efekte të rëndësishme siç është demokratizimi, demonopolizimi dhe diversifikimi i informacionit. Në ditët e sotme, prodhimi i përmbajtjes masive nuk është më ekskluzivitet i një kategorie profesionistësh të cilët janë të vetëdijshëm për impaktin e punës së tyre mbi audiencat. Teknologjia iu ka dhënë zë të gjithëve. Për rrjedhojë kanë ndodhur një sërë zhvillimesh pozitive që e kanë demokratizuar hapësirën informative duke e bërë atë më plurale.

Shumë individë dhe grupe shoqërore të papërfaqësuar në sistemin e mediave masive, kanë gjetur mundësi të përcjellin pikëpamjet e tyre mbi botën, duke mos qenë të kushtëzuara nga filtrat e masmedias. Megjithatë krahas shumë përfundimesh pozitive, teknologjia dixhitale, mbart një sërë sfidash që lidhen me prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e informacionit në hapësirën e rrjetit.

Sigurimi i informacionit të saktë, të verifikueshëm që përcillet nga burime të besueshme dhe që nuk është i manipuluar për qëllime të caktuara, mbetet ndoshta një nga sfidat më të mëdha në epokën dixhitale. Individë dhe aktorë të ndryshëm të cilët falë teknologjisë kanë mundësi të jenë prodhues dhe shpërndarës masivë të informacionit, mund të ndikojnë në mënyrë përcaktuese në rrjedhën që mund të marrin ngjarjet e aktualitetit, rrjedhë e cila ndikohet nga lajmet e rreme.

Dezinformimi është sot mekanizmi më kërcënues për demokracinë. Kushti që demokracinë të funksionojnë siç duhet janë votuesit e informuar. Lajmet e rreme mund të ndikojnë në krijimin e një shoqërie të informuar keq, që merr vendime të gabuara dhe i delegon pushtetin njerëzve të gabuar, duke kërcënuar kështu një sërë gjërash me vlerë. Kjo mund të ketë pasoja katastrofike (Levy, The Bad News About Fake News 2017). Manipulimi i opinionit përmes lajmeve të rreme dhe konspiracioneve përbën një kërcënim të madh për individin e sotëm duke prekur shumë dimensione të jetës individuale dhe shoqërore. Shqetësimi është se formimi i qëndrimeve bazuar në

informacione të rreme mund të dëmtojë kapacitetin e njerëzve për të marrë vendime të mira politike. Supozimi në këtë rast mbështetet në premisën se gjykimet politike të cilat bazohen në informacione të sakta dhe të pamanipuluara kanë më shumë gjasa të prodhojnë rezultate të mira normative.

Lajmet e rreme dhe teoritë konspirative nuk janë dukuri të lidhura thjesht me epokën dixhitale në të cilën po jetojmë. Ekzistenca e tyre dhe përdorimi për qëllime negative kanë shoqëruar botën në të gjitha etapat e zhvillimit të saj. Njerëzimi është njohur ndër shekuj me taktika që synojnë të përhapin informacione të rreme, propagandë dhe teori konspirative. Në shumë raste ato janë të qëllimshme dhe synojnë të manipulojnë opinionin publik, ta çorientojnë atë ose ta orientojnë drejt informacioneve të fabrikuara apo ta bëjnë të vështirë identifikimin e vijës ndarës mes fakteve dhe thashethemeve.

Megjithatë ritmi marramendës në zhvillimet teknologjike, përhapja e rrjeteve sociale, tendenca në rritje e komunikimit dhe konsumit të informacionit në hapësirën virtuale, prirja e aktorëve të sferës publike drejt komunikimit të pandërmjetësuar me audiencat, janë disa prej faktorëve që amplifikojnë efektin e dezinformimit, teorive konspirative dhe lajmeve të rreme.

Nga ana tjetër transformimi i ekosistemit të medias, ka bërë që roli i gazetarit profesionist në hapësirën informative online dhe përmbajtja e prodhuar prej tij të humbin terren përballë përmbajtjes së prodhuar

nga përdoruesi i rrjetit (user generated content). Me fjalë të tjera, audiencat online janë të ekspozuara direkt ndaj rrjedhës së informacionit, pa patur shkallën e duhur të njohurive, aftësitë dhe mjetet e nevojshme për të vlerësuar besueshmërinë e lajmit dhe filtruar informacionet e pavërteta.

Kryeredaktorja e “HuffPost” në një analizë mbi të ardhmen e gazetarisë në botën e dezinformimit dhe mosbesimit, e cilëson këtë kohë si një “ferr” nga i cili mund të dilet vetëm duke raportuar të vërtetën.

“Epoka e dezinformimit është një lloj ferri. Megjithatë ne duhet të këmbëngulim që *Republika* të mos vdesë. Ne duhet të ecim përpara përmes kësaj errësire derisa të gjejmë përsëri dritë, duhet të shmangim apatinë, duhet të denoncojmë frikën dhe të luftojmë injorancën. Shtypi nuk mund të përballojë të bjerë në rrëmujë dhe depresion ndërsa raporton për botën rreth nesh që është zhytur në kolaps.” (BELTON 2021)

Ndërkohë që ekspertët e medias dhe studiuesit e fushës nënvizojnë rolin e rëndësishëm që luajnë gazetarët profesionistë në betejën me dezinformacionin, nuk mund të lihet pa u përmendur aftësia e vetë audiencave për t’i bërë ballë furisë së lajmeve të rreme dhe formave të tjera të ndotjes së informacionit.

Një pjesë e mirë e studiuesve bien dakord për faktin se audiencat, të cilat janë gjithmonë e më tepër të varura nga informacioni që qarkullon në rrjetet sociale, nuk mund t’i shmangen rrezikut të lajmeve të rreme, propagandës, informacionit të fabrikuar

dhe teorive konspirative. Për më tepër shmangia e lajmeve (news avoidance) ndonëse është një dukuri e provuar shkencërisht, e cila shfaqet shpesh gjatë periudhave të krizave dhe katastrofave, nuk mund të jetë një zgjidhje afatgjatë për t'u mbrojtur nga ndotja e hapësirës informative që kanë prodhuar *fake news-et* dhe konspiracionet.

Përdoruesi i rrjetit, i cili është dhe konsumator i përmbajtjes në hapësirën online has vështirësi të shumta për të vlerësuar vërtetësinë dhe besueshmërinë e informacionit ndaj të cilit ekspozohet. Shtimi i ofertës së informacionit dhe ritmi i lartë me të cilën ai qarkullon në hapësirën online, shoqëruar me ndryshimin në zakonet e konsumit të përmbajtjes së audiencës, lënë pak hapësirë për zhvillimin e aftësive verifikuese.

Problemi ka karakter global dhe si i tillë nuk mund të adresohet vetëm lokalisht. Një sërë nismash janë ndërmarrë nga bota akademike, politkibërësit dhe ekspertët e fushave të medias, shëndetësisë dhe më gjerë. Organizata si Kombet e Bashkuara përmes UNESCO-s, Bashkimi Europian, dhe shtete të tjera po i kushtojnë vëmendje të madhe përpjekjeve për të luftuar lajmet e rreme, propagandën dhe teoritë konspirative. Përpjekjet janë fokusuar në rritjen e kapaciteteve dhe aftësive të medias dhe gazetarëve për verifikimin e fakteve, demaskimin e lajmeve të rreme dhe në përpjekjet për të rritur nivelin e edukimit për median dhe informacionin.

Situata e dezinformimit në kontekstin shqiptar

Pandemia e COVID-19, ashtu si në gjithë botën edhe në Shqipëri u shoqërua me përhapjen masive të lajmeve të rreme, dezinformacioneve dhe teorive konspirative. Audiencat shqipfolëse janë gjendur përballë një morie lajmesh që bazohen në informacione të rreme, teori konspirative dhe fakte të shtrembëruara apo të nxjerra nga konteksti.

Një sondazh i BIEPAG, i publikuar në fillim të vitit 2021, rreth përhapjes së teorive konspirative për koronavirusin në Ballkan nënvizon se afërsisht 80 përqind e ballkanasve besojnë në një ose më shumë teori konspirative. Raporti nënvizon se vendi me numrin më të madh të mbështetësve të teorive konspirative është pikërisht Shqipëria. Në këtë studim vihet në dukje fakti se konspiracionet kanë gjetur një terren të përshtatshëm në hapësirën e Ballkanit për shkak se institucionet janë të dobëta dhe besimi i publikut në to është i ulët. Të dhënat e këtij studimi nxjerrin në pah edhe një herë problemin me të cilin përballlet publiku shqiptar.

Sipas autorëve, vendi me numrin më të lartë të mbështetësve të teorive konspirative në Ballkanin Perëndimor është Shqipëria. “Këtu, të gjitha teoritë, pa marrë parasysh sa kontradiktore janë, kanë një numër më të madh mbështetësish në krahasim me njerëzit që nuk u besojnë atyre. Më të përhapurat janë teoritë

që i atribuojnë përgjegjësinë Kinës, por edhe lidhja me Bill Gates konsiderohet të ketë shumë ose njëfarë të vërtete për këtë teori sipas mendimit të më shumë se 43% të popullsisë. Në përgjithësi, në rajon gati 80% besojnë shumë, ose disi, në një prej teorive konspirative që lidhen me Covid-19. Ndërkohë që numri i atyre që i besojnë më shumë një prej teorive varion nga 41.5% në Serbi në 59.4% në Shqipëri. (Bieber, Prelec, et al. 2021).

Ndërkohë sipas një sondazhi tjetër të realizuar nga IDRA (Instituti për Zhvillim, Kërkime dhe Alternativa) në Tiranë “33% e të anketuarve besonin se rrjeti i mbulimit me internet 5G është një nga faktorët për përhapjen e shpejtë të virusit, ndërkohë që 29% e të anketuarve besonin se përmes vaksinës do të vendosen mikroçipe tek njerëzit për t’i gjurmuar ata.” (Idra 2020)

Në vijim të këtyre të dhënave, shumë hulumtime të tjera kanë trajtuar përhapjen e lajmeve të rreme dhe konspiracioneve me fokus pandeminë e shkaktuar nga COVID-19 dhe vaksinat. Një hulumtim i publikuar nga Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative BIRN, merr në analizë angazhimin që prodhojnë lajmet e rreme në median sociale. Në hulumtim janë marrë si rast lajmet e publikuara nga mediat shqiptare që kishin në fokus deklaratat e një personazhi me emrin Stefano Montanari, në një intervistë të dhënë për një kanal në Youtube. Pas analizimit të të dhënave mbi shpërndarjen e artikujve në rrjetet sociale, u vu re se “lajmi rreth deklaratave të rreme të Montanarit për Byoblu.com ka qenë një nga lajmet më të shpërndara në shqip për COVID-19 në rrjetet social”.

Analiza ka nxjerrë në pah shifrat e angazhimit të përdoruesve të rrjeteve sociale më lajmet e publikuara gjatë periudhës janar-tetor 2020. Sipas të dhënave të gjeneruara përmes platformës “Buzzsumo”, “njëzet artikujt më të shpërndarë në Facebook nga 20 mediat kryesore në vend për COVID-19, gjatë vitit të fundit, gjeneruan 93,711 reagime/shpërndarje, ndërkohë që 20 lajmet e rreme ose dezinformuese më të shpërndara morën 68,267 reagime ose 28 % më pak. (Likmeta 2020)

Periudha e pandemisë ka vënë në provë median dhe gazetarinë profesioniste në të gjithë botën. Qëndrimi i mediave tradicionale ndaj informacioneve të pabazuara në fakte është një çështje që po merr vëmendje të madhe nga studiuesit. Një pjesë e mirë e mediave në vende të ndryshme ka treguar përgjegjshmëri gjatë raportimit të ngjarjeve që lidheshin me pandeminë dhe vaksinimin. Ndërkohë që shumë institucione mediatike dhe platforma të mediave online, kanë rënë pre e dëshirës për të rritur audiencën duke i hapur rrugën publikimit të lajmeve të paverifikuara, lajmeve të rreme dhe dezinformatave.

Një situatë e ngjashme mund të vihet re dhe në median shqiptare. Teoritë konspirative dhe lajmeve të bazuara në to, kanë gjetur hapësirë në shumë media qendrore dhe lokale në vend. Studiot televizive u kanë hapur derën individëve që mbrojnë dhe përhapin këto teori pa patur asnjë kualifikim dhe ekspertizë shkencore. Në disa televizione, individë të tillë, të njohur për promovimin e ideve konspirative, janë ftuar rregullisht duke iu dhënë hapësirë të konsiderueshme, ku ata kanë

shprehur mendime mbi origjinën e virusit Sars Cov-2, efektshmërinë e vaksinave dhe efektet anësore të tyre. Në disa raste, individë të kësaj kategorie janë ftuar edhe në debate televizive duke u vendosur përballë ekspertëve të fushës së mjekësisë. (Likmeta 2021)

Debati i krijuar mes një mjekut epidemiolog dhe një konspiracionisti krahas efektit të spektaklit dhe sensacionit që përcjell tek audienca, ka kontribuar në rritjen e konfuzionit mbi këto tema. Sipas ekspertëve të medias disa nga mediat e vendit janë të vetëdijshme për rrezikun e COVID-19, por pavarësisht kësaj kanë promovuar me vetëdije dhe i kanë shpërndarë lajmet rreme, të shoqëruara me tituj bombastikë, për të gjeneruar vëmendje dhe klikime. Kjo situatë siguron që dëshmon për problemet serioze të medias dhe të sistemit mediatik.

Ndonëse raporti mes promovimit të lajmeve të rreme, konspiracioneve nga mediat tradicionale dhe ato online si dhe besimit që audienca ka mbi to, nuk mund të provohet në mënyrë direkte, është e qartë se shfaqja e individëve që promovojnë këto ide në televizionet kombëtare apo lokale si dhe hapësira që u ofrohet ideve të tyre në portalet informative, ndikon në rritjen e shkallës së dezinformimit të publiku.

Panorama bëhet edhe më e qartë nëse marrin parasysh shkallën e ulët të edukimit mediatik që ka audienca. Sa më e ulët të jetë shkalla e njohurive që audienca ka mbi median dhe lajmin, aq më i lartë bëhet rreziku i keqinformimit dhe manipulimi përmes lajmeve të rreme. Problemi i edukimit mediatik të popullsisë

është një çështje që nuk lidhet thjesht me realitetin shqiptar. Përpjekje serioze po bëhen në këtë drejtim nga vende dhe organizata të shumta në botë.

Indeksi “Media Literacy 2021” i botuar në mars të këtij viti, ku Shqipëria renditet e 33-ta, duke lënë pas vetëm Bosnjën dhe Maqedoninë Veriore, dëshmon edhe një herë se qytetarët shqiptarë vazhdojnë të jenë ndër qytetarët më vulnerabël në Europë ndaj *fake news* dhe dezinformacionit. Treguesit e shkallës së edukimit mbi median dhe informacionin japin një ide të qartë se çfarë përmasash mund të marrë ndikimi i dezinformimit mbi publikun.

Nisur nga kjo, është e nevojshme që të hulumtojmë dhe kuptojmë më tepër rreth rrugëve dhe mënyrave për të adresuar problemin e ndotjes së hapësirës informative në të cilën lundrojmë mes dezinformacioneve.

Objektivi i studimit dhe metodologjia

Ky studim ka për qëllim të identifikojë dhe analizojë problematikën që lidhet me edukimin mbi median dhe informacionin në Shqipëri në kontekstin e përhapjes së fake news, dezinformacioneve dhe teorive konspirative në median shqiptare gjatë pandemisë së COVID-19.

Studim analizon mbulimin e pandemisë së COVID-19 dhe përhapjen e fake news dhe dezinformacioneve nga media shqiptare. Gjatë këtij studimi janë marrë në shqyrtim çështje si “teoritë mbi me origjinën e virusit, lidhjet me teknologjisë 5G dhe koronavirusit, vaksinimi etj”, të cilat kanë gjetur hapësirë në raportimet e mediave në vendin tonë. Pas një vështrimi mbi origjinën e teorive konspirative dhe shkaqet psikologjike pse njerëzit janë të prirur t’u besojnë atyre, është marrë në analizë shkalla e përhapjes së tyre në hapësirën e popullsinë shqiptare. Për të zbuluar më shumë në lidhje me situatën e përhapjes dhe besimit të shqiptarëve të konspiracionet e lidhura me Covid-19, janë shfrytëzuar të dhëna empirike të mbledhura përmes anketimeve të realizuara nga institute kërkimore.

Studimi analizon një kampion të medias elektronike dhe online duke u fokusuar tek tipologjitë e informacioneve që kanë gjetur hapësirë në raportimet e mediave gjatë pandemisë. Ndërkohë në pjesën e dytë, është analizuar

situata e edukimit mbi mediat dhe informacionin të audiencave, si dhe janë diskutuar qasjet konkrete për adresimin e problemit të dezinformimit.

Për realizimin e këtij studimi është aplikuar kombinimi i metodave cilësore dhe sasiore. Në kuadër të të dhënave cilësore në studim është parashtruar një gamë e gjerë literature nga autorët më të njohur që kanë studiuar dukurinë e lajmeve të rreme dhe dezinformacionit, si dhe tema që lidhen me edukimit mbi median dhe informacionin. Në kuadër të të dhënave sasiore janë shfrytëzuar të dhëna dytësore të marra nga sondazhet dhe studimet e realizuara brenda vendit, të cilat janë krahasuar edhe me të dhëna të ngjashme nga studime të tjera rajonale.

Origjina dhe përhapja e teorive konspirative

Përpara se të hedhim një vështrim mbi origjinën dhe përhapjen e teorive konspirative është e rëndësishme të qartësohemi se çfarë janë teoritë konspirative. Me termin është abuzuar shumë gjatë dekadave të fundit, aq sa tani ka një përdorim që më shumë krijon konfuzion dhe përdoret për të stigmatizuar kundërshtarin në sfera të ndryshme të debatit publik. Debatet mbi përkufizimet e ndryshme për konspiracionet janë të pranishme si në botën akademike ashtu edhe në diskursin politik e mediatik.

Përkufizimet mbi këto teori marri një rëndësi të madhe nëse kemi parasysh faktin se përcaktimi i një teorie si konspirative përcakton pozicionin tonë në mënyrën sesi e vlerësojmë vërtetësinë e saj. Nëse përdorimi i teorisë konspirative përjashton idetë e majta, atëherë kjo nënkupton se njerëzit me bindje të djathtë mund të etiketohen si konspiracionistë. Për këtë arsye një pjesë e studiuesve të kësaj fushe kanë parapëlqyer një përkufizim sa më të gjerë dhe gjithëpërfshirës.

Në këtë linjë është dhe studiuesi Joseph E. Uscinski, Profesor i shkencave politike në Universitetin e Majemit, dhe bashkautor i “American Conspiracy Theories”, i cili shprehet se “konspiracioni është një marrëveshje

e fshehtë midis dy ose më shumë aktorëve për të uzurpuar fuqinë politike ose ekonomike, për të shkelur të drejtat e vendosura, për të grumbulluar sekrete jetësore ose për të ndryshuar në mënyrë të paligjshme institucionet qeveritare me qëllim përfitimet personale në kurriz të së mirës së përbashkët”. (Uscinski 2019)

Uscinski përpiqet të sjellë një këndvështrim të detajuar mbi përkufizimin e termave duke bërë dallimin mes përkufizimeve të termave “konspiracion”, “teorive konspirative”, “besimeve konspirative” dhe “të menduarit konspirativ”. Përkufizimi i tij mbi teorinë konspirative ka në thelb konceptin e pushtetit dhe fuqisë. Sipas tij teoria konspirative mbart një shpjegim të ngjarjeve ose rrethanave të së kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes, që përmend si shkaktar kryesor një grup të vogël personash të fuqishëm.

Komplotistët, sipas Uscinskit, veprojnë në fshehtësi për përfitimin e tyre dhe kundër të mirës së përbashkët. Ata mund të jenë qeveri të huaja ose vendase, aktorë joqeveritarë, shkencëtarë, organizata fetare, ose ndonjë grup tjetër i perceptuar si i fuqishëm dhe tradhtar. Teoritë e komplotit kanë në thelbin e tyre zotërimin e pushtetit. Kush e ka atë dhe çfarë bën me të kur vepron larg syrit të publikut dhe në fshehtësi”. (Uscinski 2019)

Njerëzit janë të prirur që ngjarjeve, në dukje të rastësishme, t’u japin kuptim përmes teorive konspirative. “Teoritë konspirative theksojnë gjithmonë një komplot të lig, shpesh nga një grup i vogël njerëzish kundër botës ose një kombi, duke shfuqizuar kështu

individë ndërkohë që i lehtëson ata gjithashtu nga përgjegjësia e tyre” (Bieber 2020).

Teoritë konspirative sugjerojnë një model ngjarësh që mund të duken të rastësishme, shpesh duke lidhur dy ose më shumë ngjarje së bashku në një narrativë koherente, duke i dhënë kështu kuptim një situatë të caktuar.

Studimet e fokusuara mbi historinë e teorive konspirative e lidhin ekzistencën e tyre me periudhat e hershme të qytetërimeve kryesore. Njerëzimi ka bashkëjetuar me ide konspirative që kanë qarkulluar në shekuj. Megjithatë ato kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve vetëm kohët e fundit. Ndonëse ka patur një konsensus për ekzistencën e tyre dhe ndikimin që këto ide kanë mbi njerëzit, ato nuk kanë përbërë një fushë specifike studimi. Shekulli i njëzetë përbën një pikë kthesë në këtë drejtim. Në vitet 90, dhe veçanërisht nën kujdesin e studimeve kulturore, hulumtimi mbi teoritë konspirative u përcaktua si një shqetësim i vazhdueshëm. (Todor Hristov and Romero-Reche 2020)

Teoritë konspirative supozojnë se gjithçka është e planifikuar dhe asgjë nuk ndodh rastësisht. Konspiracionistët e ndajnë botën qartazi në dy kampe: komplotistët e këqij dhe viktimat e pafajshme të komplotit të tyre. Sipas tyre komploti funksionon në fshehtësi dhe nuk shfaqet edhe pasi të ketë arritur qëllimet e tij.

Studiuesi i politikës Michael Barkun, i cituar nga studiuesit Michael Butter and Peter Knight, nxjerr në

pah karakteristika të ngjashme në përcaktimin e tij mbi ndikimin e teorive konspirative. Sipas tij, këto bazohen në premisën se asgjë nuk ndodh rastësisht, asgjë nuk është ashtu siç duket, dhe gjithçka është e ndërlidhur. (Butter and Knight 2020) Rrëfimet konspirative kanë qenë një tipar i spikatur i kinemasë së Hollywood-it. Pëëfytyrimi i kompleteve sekrete ka qenë gjithashtu temë qendrore e krijimeve letrare dhe popullore, duke nisur nga dramat Shekspiriane dhe deri te veprat e autorit Dan Brown.

Teoritë konspirative që qarkullojnë globalisht në internet, siç është teoria “Great Replacement”, e cila pretendon se ekziston një plan për të zëvendësuar popullsinë e krishterë të vendeve perëndimore me emigrantë myslimanë, duket se përbëjnë një formë mjaft virale të lajmeve të rreme. Idetë konspiracioniste shpesh bëhen shtrati nga ku burojnë ideologji politike dhe përdoren nga politikanët populistë për të prekur ndjenjat e njerëzve.

Dukuria e përdorimit të teorive konspirative nga partitë politike dhe nga politikanë më tendenca populiste është tashmë një shqetësim mbarëbotëror. Konspiracionizmi sipas profesorëve Butter dhe Knigh luan një rol të rëndësishëm në shumë kontekste politike në të gjithë botën.

Sidoqoftë, teoritë konspirative nuk mund të barazohen me lajmet e rreme. Prodhuesit dhe përhapësit e lajmeve të rreme shpesh kanë një objektiv të qartë për manipulimin e audiencave nisur nga qëllime të ndryshme, që nga ato monetare deri tek ato politike

apo gjeostrategjike. Në një farë mënyre ata janë të vetëdijshëm se po përhapin informacione të pavërteta dhe gënjeshtër. Nga ana tjetër shumica e atyre që besojnë te teoritë konspirative dhe bëhen pjesë e zinxhirit shpërndarës të tyre, sidomos në rrjetet sociale dhe platformat e tjera online, besojnë vërtet në atë që thonë. Ata janë të bindur se po ndihmojnë në zbulimin e së vërtetës. (Butter and Knight 2020)

Këto lloj idesh kanë një ndikim të konsiderueshëm në hartimin e politikave. Teoritë konspirative veprojnë si një alibi për shumë politikbërës, në mënyrë që ata të çojnë përpara axhendat e tyre politike dhe ekonomike. Në disa raste ky proces funksionon nga lart poshtë. Elitat politike përdorin retorikë konspirative për të përligjur ose përhapur politika të veçanta. Për këtë ata përdorin kryesisht mjetet e masmedias dhe platformat e reja të komunikimit në internet.

Ndërkohë që kemi raste kur procesi funksionon nga e kundërta. Kjo nënkupton depërtimin e teorive konspirative nga poshtë duke ndikuar në politikën përmes demokracisë direkte ose duke ndikuar në veprimet e elitave të tjera jokonspirative. Nëse marrim në konsideratë ndikimin e dyanshëm të teorive konspirative në politikbërje, ne mund të dalim në përfundimin se në disa raste, elitat politike, kulturore dhe ekonomike janë përfituese, nga njëra anë, dhe masat nga ana tjetër mund të bëhen njëkohësisht viktima të këtyre ideve.

Pse njerëzit besojnë në konspiracione dhe lajme të rreme?

Në përgjithësi mendohet se njerëzit janë të prirur të besojnë në konspiracione për shkak të mosbesimit që kanë tek autoritet. Këtu mund të përfshihen drejtuesit e shtetit, shkencëtarët, mjekët dhe mediat profesioniste. Në rast se individët përballën me një krizë të caktuar, siç është edhe rasti i pandemisë së COVID-19, e cila mbart shumë të panjohura, mungesa e besimit tek autoritet dhe ekspertët mund t'i shtyjë njerëzit drejt mendimit se pas këtyre ngjarjeve qëndron një komplot. Megjithatë studimi i arsyeve dhe faktorëve që nxitin njerëzit të besojnë konspiracionet dhe dezinformacionin, përbëjnë një fushë shumë komplekse, e cila kërkon qasje multidisiplinare.

Nëse do të nisemi nga një premisë për të korrigjuar besimet e dëmshme të njerëzve të konspiracionet, atëherë duhet të kuptojmë karakteristikat dhe burimet e tyre. Nëse krijohet një ide e qartë se kush beson në teoritë konspirative dhe dezinformatat në lidhje me COVID-19 dhe arsyet pse besojnë në to, kjo mund të ndihmojë në hartimin e strategjive për të zbutur efektet e tyre.

Një studim i disa autorëve nga Universiteti i Majemit dhe Universiteti i Louisvillit, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë përpjekur t'i japin përgjigje pyetjes;

“Pse njerëzit besojnë në teoritë konspirative”. Studimi i tyre bazohet në të dhënat nga një anketë e realizuar me të rinj të moshës 17-19 vjeç në SHBA dhe fokusohet tek teoritë konspirative që lidhen me pandeminë e COVID-19. Ata ngritën tre pyetje duke u përpjekur të kuptojnë se sa të përhapura janë besimet në lidhje me teoritë konspirative për COVID-19; cilët faktorë psikologjikë, socialë dhe politikë shpjegojnë besimin konspiracionist dhe si ndikon militantizmi politik në përhapjen e dezinformacioneve.

Studimi zbuloi se predispozita psikologjike për të refuzuar informacionin e ekspertëve dhe autoriteteve, ndryshe i përkufizuar si denalizm (mohim), tendenca për të parë ngjarjet kryesore shoqërore dhe politike si produkt i kompleteve (të menduarit konspirativ) dhe motivet militanteske janë faktorët më të fortë që shpjegojnë se pse njerëzit besojnë teoritë e konspiracionit për COVID-19. Për shkak se dy nga këta faktorë - të menduarit konspirativ dhe mohimi - bazohen në një mosbesim të thellë ndaj ekspertëve dhe figurave të autoritetit, korrigjimi i besimeve të keqinformuara dhe konspirative mes individëve që shfaqin nivele të larta të të menduarit konspirativ mund të jetë shumë i vështirë. (Uscinski, Enders, et al. 2020)

Studime të tjera kanë zbuluar se konspiracionizmi përbën një sistem besimi monologjik, që lidhet me një ide qendrore, siç është bindja se autoritetet dhe zyrtarët angazhohen në mashtrim masiv të publikut për të arritur qëllimet e tyre dashakeqe. Korrelacioni me këtë ide qendrore i jep mbështetje çdo teorie konspirative. (Michael J. Wood and Sutton 2012)

Ndërkohë edhe pse në pamje të parë mund të duket jo logjike, njerëzit që besojnë një teori konspirative kanë më shumë gjasa të besojnë një tjetër, edhe kur ato teori janë kontradiktore me njëra-tjetrën. Shembull për këtë mund të jepet rasti i Princeshës Diana e cila vdiq në një aksident me makinë në vitin 1997. Studiuesit kanë vënë re se disa njerëz, të marrë në studim, besonin dy teori kontradiktore. Ata i besonin si teorisë se Princesha Diana në të vërtetë është ende gjallë, por në mënyrë kontradiktore besonin dhe se ajo është vrarë. Kjo duket se tregon irracionalitetin e theksuar të subjekteve të saj.

Njerëzit mund të tërhiqen nga teoritë konspirative kur krahasuar me shpjegimet jo-konspirative, ato përpiqen të përmbushin motive të rëndësishme social-psikologjike që mund të karakterizohen si epistemike (dëshira për të kuptuar, saktësi dhe siguri subjektive), ekzistenciale dëshira për kontroll dhe siguri shoqërore (dëshira për të ruajtur një imazh pozitiv të vetvetes ose grupit), (Douglas, Sutton and Cichocka 2017).

Problemi i ndotjes së informacionit në hapësirën online përfshin një spektër të gjerë. Krahas teorive konspirative, lajmet e rreme kanë marrë shumë vëmendje dekadën e fundit, edhe për shkak të përdorimit masiv të termit në ligjërimin politik dhe më e gjerë. Faktet objektive janë më pak me ndikim në formimin e opinionit publik sesa thirrja ndaj emocioneve dhe bindjeve personale. Lajmet e rreme krijojnë post-të vërteta dhe post-fakte (Kano 2018). Krahas kësaj, termi në vetvete shpesh është bërë objekt debati mes kërkuesve të fushës së medias, shkencave politike dhe psikologjisë.

Kohët e fundit, pavarësisht popullaritetit që ka arritur ky term, sidomos në skenën politike amerikane, mes studiuesve ka një prirje për ta parë dukurinë me një lente më të gjerë. Dezinformimi përbën një dukuri mjaft komplekse, dhe shpesh termi mbetet i pamjaftueshëm për të shpjeguar gjithë kompleksitetin e tij.

Përpyekjet për të përkufizuar termin kanë ardhur në rritje paralelisht me popullaritetin që ka fituar ky term në diskursin publik dhe me diskutimet për dëmet e mundshme që ai shkakton mbi informimin e audiencave dhe për rrjedhë edhe mbi funksionimin e demokracisë (Çela 2020). Autorë të ndryshëm janë përqendruar në dy dimensione kryesore të dukurisë: “nivelet e fakticitetit dhe mashtrimit. Kjo do të thotë se në përkufizimin e lajmeve të rreme baza nga ku orientohemi lidhet me nivelin e vërtetësisë që ka një lajm i caktuar dhe me shkallën e mashtrimit që ai mbart. Kjo tipologji shërben për të sqaruar atë që nënkuptojmë me ‘lajme të rreme’ dhe për të orientuar studimet e ardhshme në këtë fushë.” (Tandoc, Lim and Ling 2018)

Bazuar në këtë qasje, koncepti i “fake news”, mund të përmbledhet në gjashtë tipologji të ndryshme: informacion i fabrikuar, manipulime, lajme satirike, lajme humoristike, reklamë dhe propagandë.

Pyetja shtrohet a mjafton për të përfshirë gjithë dimensionin e dezinformacionit kjo ndarje në gjashtë tipologji? Për këtë temë ekziston një debat i gjerë. Për të patur një shkallë më gjithëpërfshirëse, termi “informacion problematik” duket se përshtatet më së miri me ekosistemin aktual të informacionit.

Shumica e termave të përdorur lidhen me qëllimin apo motivet e “prodhuesit” të informacionit. Dezinformimi përdoret në përgjithësi për t’iu referuar përpjekjeve të qëllimshme (dhe shpesh të orkestruara) për të çorientuar apo manipuluar publikun nëpërmjet shpërndarjes së informacioneve mashtruese. Dezinformimi zakonisht përdoret për t’iu referuar një informacioni të pasaktë që është krijuar dhe përhapur pa ndonjë qëllim manipulues apo keqdashës (Ireton and Posetti 2018). Ndërkohë autorë të tjerë sugjerojnë përdorimin e termit ‘keqinformim’ për të përshkruar “informacionin, i cili bazohet në realitet dhe është përdorur për të shkaktuar dëm ndaj një personi, organizate ose shteti” (Marwick 2018).

Përmbajtjet sensacionale me qëllim komercial përbëjnë një nga format më të përhapura të informacioneve të rreme. Ato janë informacione të pavërteta që nuk kanë ndonjë prapavijë apo qëllim ideologjik. dhe që synojnë kryesisht të orientojnë trafikun e përdoruesve në faqe të caktuara të internetit, në mënyrë që përfitojnë nga të ardhurat e reklamave online.

Ndërkohë që një formë tjetër janë dhe “dezinformimet e sponsorizuara nga shtete apo qeveri”. Në këtë rast kemi të bëjmë me qëllim parësor influencimin e publikut (Titcomb and Carson 2018).

Studiuesit kanë identifikuar si formë mjaft të përhapur të lajmeve të rreme faqet online që kanë një qasje të dukshme partizane. Këto media zgjedhin të kombinojnë ose bashkojnë në mënyrë të qëllimshme, faktet me opinionet duke krijuar një perceptim të

shtrembëruar për publikun. Problemi nuk është thjesht mosrespektimi i parimeve dhe normave të gazetarisë, siç është paanshmëria apo objektiviteti.

Satira dhe informacioni me përmbajtje humoristike përbën një tjetër formë të lajmit të rremë. Përmbajtje të tilla përhapen shpesh ne internet me synim parësor humorin. Mediat e reja publikojnë përmbajtje të tillë kryesisht për të rritur angazhimin e audiencave dhe përdoruesve të rrjetit me postimet e tyre. Kjo krijon një problematikë për audiencat që nuk e kanë njohurinë dhe aftësinë e duhur për të klasifikuar llojet e informacionit. Ato mund të keqinformojnë audiencat, sidomos në rastet kur nxirren nga konteksti dhe të riserviren si informacione serioze nga portale apo llogari të ndryshme në rrjetet sociale.

Një ndarje të ngjashme tipologjike në lidhje me lajmin e rremë e gjejmë edhe në një studim të autorit Damian Tambini nga *“London School of Economics and Political Science Department of Media and Communications”*, të publikuar në mars të vitit 2017. E veçanta e përkufizimit dhe ndarjeve që iu bën ai lajmeve të rreme, qëndron në përfshirjen e “gazetarisë së dobët” si një burim që çon tek të tilla lajme. Në këtë rast autori e lidh problemin me gazetarët që merren me të ashtuquajturat lajme rozë dhe që shpesh herë përfshihen nga dëshira për të publikuar konspiracione. (Tambini 2017)

Pavarësisht këndvështrimeve të ndryshme mbi terminologjinë dhe tipologjitë, duket se shumë prej kërkuesve bien dakord përsa i përket efektit që ka “informacioni i infektuar” mbi demokracinë. Ideja kryesore ku

palët arrijnë në një konsensus, është se lajmet e rreme kërcënojnë procesin demokratik duke synuar manipulimin e opinionit dhe për rrjedhojë diktojnë vendimmarrjen e qytetarëve (Giusti and Piras 2021).

Sido që të jetë qasja për përdorimin e termit, ideja për të kuptuar motivet se përse njerëzit priren të besojnë informacione të rreme apo të pabazuara në fakte, mbetet shumë intriguese. Ashtu si në rastin e teorive konspirative, edhe për lajmet e rreme nevoja për t'u thelluar më shumë mbi motivet që qëndrojnë pas besimit të këto informacione lidhet me dëshirën për të ndërtuar strategji sa më të efektshme dhe për të mbrojtur njerëzit nga efekti i tyre. Ideja bazë është: nëse kuptojmë se çfarë i shtyn njerëzit të besojnë lajmet e rreme dhe informacionet e fabrikuara, atëherë mund të kemi mjaftueshëm të dhëna për t'i kundërshtuar dhe demaskuar fushatat e dezinformimit.

Sipas Neil Levy dhe Robert M. Ross, dy profesorë në Macquarie University, një hipotezë e natyrshme për njerëzit besojnë lajmet e rreme, veçanërisht që ato janë *prima facie* (në pamje të parë) të papranueshme, ka të bëjë me kufizimet njohëse apo me injorancën, ose të dyja së bashku.

Ky model bazohet në mangësitë që kanë njerëzit, të cilat i shtojnë të besojnë të pabesueshmen ose joracionalen. Studimet kanë zbuluar se ky model ka si variabël të dytë dhe ideologjinë politike. Tema mbi të cilat ka një ndarje të madhe partiake, mund të vërehet se njëra palë është në kundërshtim me konsensusin shkencor. Vlerat tona - veçanërisht, ndjenja jonë e përkatësisë në një kulturë

të caktuar - paragjykon njohjen tonë, në mënyrë që të refuzojmë burimet e informacionit kur ato bien ndesh me besimet qendrore të atij identiteti. Individët me kapacitete më të mëdha njohëse kanë aftësi më të mëdha për të shpjeguar të dhënat e papërshtatshme (Levy and Ross 2021).

Ritmi që i ka mundësuar interneti dhe teknologjitë dixhitale të qarkullimit të informacionit, bën që njerëzit shpesh nuk ia dalin të dallojnë të vërtetën nga trillimi sepse nuk arrijnë të ndalen dhe të reflektojnë për saktësinë e asaj që shohin në mediat sociale (Pennycook and Rand 2021).

Ne konsumojmë një sasi të tillë informacioni në një ditë, saqë e kemi shumë të vështirë të përqendrohemi dhe ta analizojmë atë. Kjo është faza që njihet si mbingopje nga informacioni.

Një tjetër premisë nga ku mund të nisemi për të ndërtuar strategji efikase për të luftuar ndikimin negativ dhe përhapjen e “lajmeve të rreme”, është e nevojshme të kuptojmë arsyet se përse njerëzit ndërveprojnë në nivel kaq të lartë me këtë lloj përmbajtje.

Është e qartë tashmë, se shkalla e lartë e ndërveprimit për të cilin diskutohet më tepër, është ajo që ndodh në hapësirën virtuale. Përdoruesit e rrjeteve sociale ndërveprojnë me lajmet e rreme të postuara në platformat e medias sociale, duke i pëlqyer, komentuar dhe rishpërndarë ato. Në njëfarë mënyre njerëzit, duke ndërvepruar me lajmet e rreme, kthehen në përhapës të këtyre lajmeve. Gjetjet e kërkuesve të fushës

sugjerojnë se faktorët psikologjikë mbizotërojnë kur njerëzit besojnë te thashethemet, propaganda apo lajmet e rreme.

Pyetja që studiuesja Alice E. Marwick ngre në studimin e saj është se përse njerëzit shpërndajnë lajme të rreme. Sipas saj, përdoruesit e rrjeteve sociale shpërndajnë informacione të rreme për të mbështetur besimet dhe qëndrimet e tyre para-ekzistuese. Ndërkohë qëllimi i dytë ka të bëjë me nevojën për të prezantuar identitetin e tyre para të ngjashmëve të tjerë (Marwick 2018).

Përhapja e informacionit të rremë ka një lidhje të ngushtë edhe me zakonet dhe motivet e përdorimit të medias sociale. Ndër motivet kryesore të cilat shihen si arsye se pse përdoruesit përhapin qëllimisht informacion të paverifikuar, janë besimi i krijuar ndaj burimeve të informacionit në internet, nevoja për paraqitjen e vetvetes para të tjerëve, frika apo ankthi nga humbja e vëmendjes së të tjerëve dhe lodhja nga mediat sociale.

Ndërveprimi ynë si përdorues në rrjetet sociale çon në krijimin e perceptimeve mbi besueshmërinë e burimeve të informacionit në hapësirën online. Kërkimet në këtë fushë kanë zbuluar se ekziston një lidhje negative midis besimit në internet dhe verifikimit të lajmeve para ndarjes me përdoruesit e tjerë në internet. Kjo do të thotë se përdoruesit e mediave sociale me besim të lartë në përmbajtjen e shpërndarë në rrjetet sociale janë të prirur t'i ndajnë ato me të tjerët pa i verifikuar paraprakisht (Talwara, et al. 2019).

Teoritë konspirative dhe lajmet e rreme rreth pandemisë

Përhapja e virusit SarsCov-2 që në fillim u shoqërua me një shkallë të lartë paniku dhe frike. Këto ndjenja u nxitën më së shumti nga mungesa e njohurisë në lidhje me virusin. Në deklaratat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe shumë ekspertëve të njohur në botë, theksohej se ky virus ka shumë të panjohura. Në një situatë të tillë u rrit nevoja e njerëzve për më shumë informacion. Në muajt e parë kur shumë vende të botës, përfshi dhe Shqipërinë, u izoluan në karantinë të plotë, rutina jonë e konsumit të informacionit ndryshoi rrënjësisht. Disa faktorë të ndërlidhur ndikuan te njerëzit në formimin e rutinave të reja përsa i përket konsumit të lajmeve. Shkalla në të cilën pandemia ndikoi përditshmërinë e njerëzve, ishte faktori përcaktues në formimin e rutinave të reja të konsumit të lajmit. Ata tek të cilët pandemia ndikoi në mënyrë domethënëse jetën e përditshme, zhvilluan zakone të reja në raport me lajmet. Ndërsa konteksti shoqëror është një tjetër faktor që ndikoi në mënyrën sesi ne ndërtuam raporte me mediat dhe informacionin. E thënë ndryshe, nëse miqtë dhe të afërmit ishin të përfshirë në diskutime të shpeshta mbi pandeminë, kjo ndikoi që ne të ndryshonin sjelljen tonë në raport me lajmin (Broersma and Swart 2021).

Emocionet luajtën gjithashtu një rol të rëndësishëm në konsumin e informacionit. Pasiguria, frika dhe paniku ishin të pranishme prej çastit të parë kur u shfaq pandemia. Kjo bëri që kërkesa e audiencave për informacion të rritet ndjeshëm.

Infodemia ishte termi që shoqëroi përhapjen e virusit që nga çasti i parë, duke treguar se bota po përballej me dy pandemi njëkohësisht. Nga njëra anë përhapja e virusit SarsCov-2 dhe nga ana tjetër vala e pandalshme e dezinformimit që ndikon jo pak në menaxhimin e situatës së krizës. Hulumtime të shumta janë fokusuar në mënyrën e përhapjes së teorive konspirative që shoqërojnë fazat e pandemisë. Përhapja e lajmeve të rreme dhe ideve konspiracioneve ka goditur ndjeshëm edhe audiencat shqipfolëse, duke nxjerrë edhe një herë në pah nevojën për edukimin e tyre në lidhje me median dhe informacionin.

Publiku në mbarë botën u njoh për herë të parë me konceptin e infodemisë që në fillim të muajit shkurt, kur Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ngriti shqetësimin e përhapjes së informacioneve të rreme. OBSH përdori termin “infodemic” duke theksuar se “Përhapja e Covid-19 dhe reagimi ndaj pandemisë është shoqëruar me një *infodemi* masive, duke e bërë të vështirë për njerëzit të gjejnë burime të besueshme dhe këshilla të sigurta, kur ata kanë nevojë për to.” Njerëzit kishin nevojë të theksuar për informacion të shpejtë dhe të saktë duke kërkuar të mësonin më shumë rreth koronavirusit. Nevoja e njerëzve për informacion të shpejtë është shfrytëzuar vazhdimisht nga aktorë

të ndryshëm për të përhapur teori konspirative dhe lajme të rreme. Organizatat e ndryshme të përfshira në menaxhimin e krizës së pandemisë vazhdojnë të vënë në dukje shqetësimin që sjell infodemia, në shëndetin e njerëzve.

Studimet dhe monitorimet e mëvonshme tregojnë se vetë OBSH u bë subjekt i teorive konspirative që vazhdojnë të shoqërojnë situatën pandemike në të gjithë botën.¹ Disa teori konspirative e përfshijnë OBSH-në dhe kreun aktual të saj në të ashtuquajturin komplot botëror që kërkon të pakësojë numrin e popullsisë në botë. Menjëherë pas alarmit të ngritur për rrezikun e lajmeve të rreme, një numër i ngjarjesh me pasoja të rënda mbi shëndetin u raportuan në disa vende të botës.

Shembullpërkëtoishinrastetkurnjerëzitekeqinformuar konsumuan alkool shumë të përqendruar me shpresën se në këtë mënyrë mund të dezinfektonin trupin dhe të vrisnin virusin. Studimet e mëvonshme treguan se këto lajme që qarkulluan në rrjetet sociale ishin të rreme. Si pasojë e këtij deziformimi rreth 800 njerëz vdiqën, ndërsa 5,876 u shtruan shtruar në spitale. Tek afro 60 persona pirja e metanolit si kurë kundër koronavirusit shkaktoi verbëri të plotë. Informacione të ngjashme kanë qenë shkaku i raportuar i 30 vdekjeve në Turqi, ndërsa në Katar, dy burra të shëndetshëm konsumuan dezinfektues për pastrimin e sipërfaqeve të jashtme.

¹ Raporti mbi situatën e Covid-19 të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, 2 February 2020. <https://www.who.int/docs/default-source/koronaviruse/situation-reports/20200202-sitrep-13-ncov-v3.pdf>

Për nga përmbajtja, dezinformacionet mbi pandeminë kanë larmi formash. Ato variojnë nga informacionet tërësisht të fabrikuara, deri te lajme që përmbajnë informacione të deformuara, gjysmë të vërteta apo lajme të nxjerra jashtë kontekstit. Fotografi dhe video të ndryshme (siç ishte rasti i imazhit që tregonte një tren me mbishkrimin COVID-19) u bënë virale në rrjet dhe patën ndikim të madh në keqinformimin e audiencave, përpara se ato të demaskoheshin si të rreme. Shumica dezinformacioneve mbi situatën pandemike, përbëhen nga ripërpunime të lajmeve ekzistuese ose informacioneve të vërteta (Brennen, et al. 2020)

Disa nga format më të përhapura të lajmeve të rreme kombinojnë një sasi të vogël informacioni të vërtetë dhe një mori informacionesh të fabrikuara ose rikontekstualizuara. Kombinimi në këtë formë i disa të vërtetave më shumë të pavërteta e bën tejet të vështirë procesin e verifikimit, sidomos për syrin e audiencave që nuk kanë njohuri në këtë drejtim. Këto forma hibride të informacionit ndikojnë edhe në agjendën e mediave konvencionale duke shërbyer shpesh herë si burim i lajmeve apo kronikave televizive. Në këtë kategori mund të përfshihen lajme që kanë si subjekt këshillat mjekësore për parandalimin apo trajtimin e virusit. Eksperiencat e individëve që e kishin kaluar sëmundjen dhe dëshironin të ndanin me miqtë e tyre përjetimet dhe këshillat, u bënë një nga format e përmbajtjes që shkaktoi shumë paqartësi. Për shkak se në disa raste, këto eksperiencia personale, filluan të qarkullojnë në media sociale si kura që ndihmonin në trajtimin e sëmundje, mjekët dhe specialistët e fushës ngritën

shqetësimin për këtë lloj informacioni duke theksuar se kurat dhe këshillat e përhapura në rrjetet sociale nga individë që nuk kanë asnjë ekspertizë nuk duhet të merren në konsideratë. Megjithatë, rrjetet sociale u mbushën me receta dhe përjetime të individëve, identiteti i të cilëve ishte i vështirë të verifikohet në hapësirën virtuale. Llogari të caktuara në Facebook, apo kanale në Youtube përhapnin rekomandime, ku përfshiheshin barna dhe kura të ndryshme që kanë funksionuar në një rast specifik dhe që mund të ndihmonin dhe të tjerët.

Shkalla e përhapjes së konspiracioneve dhe lajmeve të rreme

Shqipëria është një nga vendet e prekura në një shkallë të konsiderueshme nga përhapja e dezinformacioneve në lidhje me pandeminë e COVID-19. Një raport i Shërbimit Informativ Shtetëror i publikuar në 16 gusht 2021, paraqet një panoramë të përhapjes së teorive konspirative gjatë pandemisë dhe angazhimin e aktorëve të ndryshëm në fushata dezinformimi. Sipas raportit, i cili gjeti një pasqyrim të gjerë në mediat vendase, aktorë jo-perëndimorë, u angazhuan në fushata dezinformacioni edhe në lidhje me COVID-19.

Këta aktorë, shtetërorë dhe jo-shtetërorë, duke përdorur mediat online dhe rrjetet sociale, u fokusuan në fushata dezinformuese që kishin për qëllim të përhapnin supozime të tilla si “Perëndimi e ka krijuar virusin, virusi është një armë biologjike, se BE-ja po dështon në menaxhimin e pandemisë, institucionet euro-atlantike nuk kanë kapacitete reaguese kolektive, etj” (Panorama 2021). Raporti vë në dukje faktin se përhapja e këtyre informacioneve konspirative dhe fushata e dezinformimit në përgjithësi pati ndikim në perceptimin e publik në rajon dhe Shqipëri. Këto fushata ndikuan që në publik të ndihet një rënie të besueshmërisë për masat kundër COVID-19 dhe rrezikshmërinë reale të pandemisë. Rajoni i Ballkanit

përbën një arenë për përplasjen e interesave të fuqive të mëdha, të cilat krahas mjeteve dhe metodave të njohura, përdorin edhe fushatat e dezinformimit si mjet propagande.

Ndërkohë një raport i EEAS (European External Action Service) vë në dukje rolin e vendeve si Rusia në nxitjen e fushatave të dezinformimit në Europë dhe Ballkan. Sipas raportit në fjalë mediat ruse që synojnë audienat ndërkombëtare përqendrohen kryesisht në teoritë e konspiracionit rreth “elitave globale” që shfrytëzojnë virusin për qëllimet e tyre. Qëllimi në këtë rast është nxitja e mosbesimit tek autoritetet kombëtare dhe evropiane dhe sistemet e kujdesit shëndetësor, institucionet ndërkombëtare dhe ekspertët shkencorë. Raporti nënvizon faktin se narrativat që përshkruajnë virusin si “të bërë nga njeriu” janë të pranishme në dezinformimin që synon të gjithë audienat.²

Një tjetër vend që përmend raporti i EEAS, është Kina. Në mbulimin që mediat kineze i kanë bërë pandemisë vihet re një tendencë propagandistike që nxjerr në pah avantazhin e Kinës si një shtet i centralizuar në efikasitetin e përballjes me virusin. Po kështu mediat kineze janë përqendruar të përhapin në opinion publik ndërkombëtar teori konspirative që e shmangin origjinën e virusit nga vend i tyre dhe e lidhin përhapjen

² “Eeas Special Report: Disinformation On The Koronavirus – Short Assessment Of The Information Environment”, MARCH 19, 2020. <https://euvsdisinfo.eu/eeas-special-report-disinformation-on-the-koronavirus-short-assessment-of-the-information-environment/>

e tij me shtete europiane apo Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Nëse fokusohemi te raportimi i mediave shqiptare gjatë gjithë situatës së pandemisë është e lehtë të identifikojmë lajme që mund të përputhen me qasjet konspirative të vërejtura në raportin e EEAS. Me fillimin e përhapjes së virusit, mediat filluan të raportojnë lajme që kishin të bëjnë më origjinën e virusit dhe informacione që vinin në dyshim ekzistencën e tyre.

Me kalimin e kohës këto lajme ua lanë vendin teorive konspirative që nuk e vinin në diskutim ekzistencën e tij, por përqendroheshin në idenë se virusi është një lloj ‘arme biologjike’ e krijuar nga elitat botërore. Natyra e dezinformimit ka ndjekur ecurinë e pandemisë në të gjitha fazat e saj. Në ditët e sotme informacionet e rreme që qarkullojnë më shumë kanë të bëjnë me vaksinat. Mediat janë përqendruar shumë në publikimin e lajmeve që kanë në fokus efektet anësore të vaksinave. Në median shqiptare gjen shpesh publikime që kanë referencë media nga vende të ndryshme ku flitet për raste të vdekjeve si pasojë e vaksinave. Nëse bëni një kërkim të thjeshtë në Google me togfjalëshin “vdes pas vaksinës” do të vini re një mori lajmesh të publikuara në mediat shqiptare online dhe numër të konsiderueshëm videosh në kanalet e YouTube.

Dezinformimi në lidhje me vaksinat ka natyrë mjaft komplekse. Qëndrimet kundër vaksinave janë shumë më të vjetra se pandemia e COVID-19. Njerëz dhe grupime kundër vaksinës kanë ekzistuar gjithmonë. Sot dezinformacioneve në lidhje këtë çështje u

bashkohen edhe fushatat e sponsorizuara nga shtetet dhe kompanitë konkurrenente në tregun e vaksinës.

Një studim i publikuar në revistën shkencore “Media International Australia”, sjell në vëmendje rastin e gazetës së njohur italiane “La Stampa”, e cila në datën 7 prill 2020, botoi një opinion që promovonte në mënyrë aktive teoritë e konspiracionit në lidhje me rreziqet shëndetësore të 5G. Artikulli u hoq nga faqja e gazetës disa kohë pas botimit, ndërkohë që materiali vazhdoi të qarkullonte në një version të kapur nga arkivi i internetit dhe arriti të ribotohej në rreth 210 faqe te tjera, me të paktën 3.3 milion ndjekës.³


Në një protestë të organizuar në fund të muajit maj 2020 në Tiranë, organizatorët bënë deklarata që e lidhnin përhapjen e virusit me teknologjinë 5G. Ata hodhën parulla kundër vaksinimit të detyrueshëm ndaj COVID-19, vaksinë që sipas tyre është duke u përgatitur dhe ka si qëllim injektimin e disa mikroçipave kontrollues në trupat e popullatës.

Një prej organizatorëve të protestës shprehej se “Kjo është një skemë ndërkombëtare në interes të pak familjeve në botë, të cilët dëshirojnë të ulin numrin e popullsisë në botë për ta kontrolluar më mirë dhe për të mikroçipuar popullsinë, nëpërmjet një vaccine me nanothërmija dhe nëpërmjet sistemit 5G – që duan të na fusin në trup nëpërmjet kësaj vaccine” (Bogdani 2020).

³ “Corona? 5G? or both?: the dynamics of COVID-19/5G conspiracy theories on Facebook”, Axel Bruns, Stephen Harrington and Edward Hurcombe, Media International Australia, 1–18, 2020.

Protesta të ngjashme janë organizuar edhe përgjatë vitit 2021. Personazhet që udhëheqin këto protesta janë të pranishëm në studiot e televizioneve kryesore dhe portalet informative. Deklaratat dhe qëndrimet e tyre, që shpesh nuk i referohen asnjë burimi apo fakti shkencor, ripublikohen në portalet informative dhe llogaritë e mediave kryesore në rrjetet sociale me tituj sensacionalë.

Në fillim të marsit, Euronews Albania kreu një sondazh me MRB mbi besimin ndaj vaksinave, duke gjetur se mbi 46 përqind e shqiptarëve nuk i besojnë vaksinës COVID-19, ndërsa 37.3 përqind e të anketuarve deklaruan se absolutisht nuk do t'i nënshtrohen vaksinimit.⁴



Të dhënat e publikuara nga Euronews Albania

⁴ “Mbi 46% e shqiptarëve nuk besojnë te vakcina kundër COVID-19”, 23 February, 2021. <https://euronews.al/al/i-pakategorizuar/2021/02/23/mbi-46-e-shqiptareve-nuk-besojne-tek-vakcina-kunder-covid-19/>

Ndërsa një studim i ngjashëm i realizuar në Malin e Zi, tregon shifra edhe më të larta të mosbesimit te vaksinat. Sipas sondazhit të realizuar nga kompania e kërkimeve Ipsos me mbështetjen e Ambasadës së MB në Podgoricë dhe UNICEF-it , 43% e qytetarëve në Malin e Zi beson në idenë se “dëmet e shkaktuara nga vaksina janë duke u fshehur në mënyrë që kompanitë farmaceutike të vazhdojnë të kenë fitime në të gjithë botën”.⁵

⁵ “Kush beson në teoritë konspirative në lidhje me vaksinat?”
27 July 2021. <https://www.unicef.org/montenegro/sq/histori/kush-beson-n%C3%AB-teorit%C3%AB-konspirative-n%C3%AB-lidhje-me-vaksinat>

Analiza e diskursit mediatik mbi pandeminë

Roli i medias në informimin e drejtë të audiencave merr në një rëndësi të madhe sidomos në kohën e krizave globale. Gazetarët profesionistë dhe institucionet e masmedias mbeten ende një burim i rëndësishëm informimi. Ndonëse ekosistemi mediatik ka ndryshuar shumë dhe oferta informative është diversifikuar në maksimum falë përhapjes së rrjeteve sociale, televizionet janë ende të rëndësishme, veçanërisht në besimin që audeincat kanë te burimet e informacionit.

Mediat në Shqipëri, ashtu si në çdo cep të globit u përballën me sfida të mëdha gjatë raportimit për koronavirusin dhe pandeminë në përgjithësi. Gjatë kësaj periudhe janë vënë në provë thujse të gjitha konceptet deontologjike dhe etike të gazetarisë. Mbulimi i ngjarjeve me fokus përhapjen e koronavirusit dhe fushatën e vaksinimit përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes informative të publikuar në mediat audiovizive dhe ato online. Televizionet kombëtare dhe ato lokale i kanë kushtuar një hapësirë shumë të madhe këtyre tematikave. Krahas kronikave në edicionet e lajmeve, debatet televizive trajtojnë thujse çdo ditë tema të lidhura me pandeminë dhe vaksinimin.

Ndërkohë në mediat online mbulimi i temave të ngjashme është edhe më i lartë. Portale të pavarura dhe disa të lidhura me një media tradicionale publikuan informacione me burim median ndërkombëtare. Shpesh në garën për klikime për më shumë audiencë, në portalet informative zunë vend teori të ndryshme konspirative dhe informacione të pavërtetuara.

Gazetari dhe studiuesi Emirjon Senja në një analizë të publikuar në faqen e Institutit Shqiptar të Medias ofron të dhëna të rëndësishme përsa i përket mbulimit të pandemisë nga median online. Referuar të dhënave të përpunuara nga BuzzSumo, nga 1 janari 2021 deri në 30 qershor 2021, në mediat online në Shqipëri janë publikuar gjithsej 22 713 artikuj, të cilët kanë patur në titull ose në brendësi fjalën “Covid-19” (Senja 2021). Ai vë në dukje rolin e algoritmeve të rrjeteve sociale dhe motorëve të kërkimit të cilat ndikojnë në preferencat e përdoruesve për informacionin.

Nga monitorim i mediave shqiptare në kuadër të këtij studimi del se mediat në përgjithësi nuk arritën të kenë një qasje të përgjegjshme dhe të unifikuar gjatë raportimit të pandemisë. Ato u bënë pjesë e politizimit të çështjes dhe u ndikuan nga ambicia për më shumë vëmendje nga audienca dhe për klikime nga përdoruesit e rrjetit. Përgjatë fundit të vitit 2020 dhe fillimit të vitit 2021, periudhë kjo që përkonte dhe me garën zgjedhore për zgjedhjet e 25 prillit, u vu re politizimi i skajshëm për temat që lidheshin me menaxhimin e pandemisë dhe fushatën e vaksinimit.

Ky politizim prodhoi edhe polarizimin e mbulimit mediatik. Një pjesë e medias i pasqyroj temat mbi vaksinën në kontekstin e debatit politik dhe garës elektorale. Kjo prodhoi një efekt të padëshiruar në besimin që audienca kishte ndaj vaksinimit në përgjithësi dhe vaksinave specifike.

Kjo gjë vërtetohet edhe nga rezultatet e publikuara nga Euronews Albania, të cilat tregonin një shkallë të lartë mosbesimi dhe refuzimi të vaksinës.

Mediat që kishin një qasje redaksionale kritike ndaj qeverisë u përqendruan në tema që vinin në diskutim efikasitetin e një vaccine specifike të prodhuar nga një kompani kineze. Në kuadër të kësaj qasjeje në media të ndryshme ishin të pranishëm specialistë shqiptarë të angazhuar në Europë dhe SHBA që mbronin idenë se kjo vaksinë është joefikase.⁶ Ndërkohë që një narrativë kryesore e këtyre mediave, gjatë fushatës elektorale ishte “Vaksinimi në fakt është vaksinim elektorale”, duke nënvizuar përdorimin për efekte elektorale që qeveria po i bënte fushës së vaksinimit masiv.

Ndërkohë që mediat pro-qeveritare i kushtuan një vëmendje të madhe mbulimit të deklaratave të drejtuesve të qeverisë që tregonin numrin e vaksinave të siguruara për popullatën. Pothuajse çdo deklaratë e kryeministrit Edi Rama, e publikuar në faqen e tij në Facebook mbi numrin e vaksinave që mbërrinin

⁶ “Virologu shqiptar: Jam shumë i shqetësuar për vaksinën kineze”; <https://www.syri.net/politike/416615/virologu-shqiptar-jam-shume-i-shqetesuar-per-vaksinene-kineze>, 15 April, 2021

në Shqipëri, gjeti vend në përmbajtjen informative të mediave. Narrativa kryesore që këto media i përcollën audiencës ishte: “Opozita po dezinformon në lidhje me vaksinat për të dëmtuar fushatën e vaksinimit dhe për të hequr përfitimin e mundshëm të qeverisë në zgjedhjet e 25 prillit”.

Polarizimi i mediave dhe polarizimi i mbulimit çoi në një përplasje të hapur. Portale dhe media të ndryshme filluan të publikojnë materiale në të cilat pretendonin se kishin demaskuar lajmet e rreme të konkurrentëve të tyre.⁷

Afrimi dhe nisja e fushatë zgjedhore, bëri që disa mjekë, të cilët ishin kthyer në figura referuese të medias gjatë fillimit të pandemisë, të bëhen pjesë e fushatës elektorale. Përfshirja e tyre me mesazhe në dukje sensibilizuese por të sponsorizuar dhe përgatitur nga qeveria dhe partia në pushtet, ndikoi në konfuzionin e mëtejshëm të audiencës dhe në polarizimin e qëndrimit ndaj pandemisë dhe vaksinave. Kjo ngjarje mori një vëmendjen të madhe nga mediat shqiptare.⁸

⁷ “Lajmi i rremë/Ja pse shfaqet Serbia në marrëveshjen me Pfizer, si po përpiqet opozita të manipulojë opinionin publik”, 11 January 2021, <https://shqiptarja.com/lajm/lajmi-i-rreme-ja-pse-shfaqet-serbia-ne-marreveshjen-me-pfizer-si-po-perpiqet-opozita-te-manipuloje-opinionin-publik>

⁸ “Pipero në spotin e PS: Politika e opozitës dëmton procesin jetik të vaksinimit”, 9 April, 2021. <https://gazetamapo.al/pipero-ne-spotin-e-ps-politika-e-opozites-demton-procesin-jetik-te-vaksinimit/>

Narrativat mbizotëruese në media

Gjatë mbulimit që media në Shqipëri u bëri ngjarjeve të lidhura me pandeminë e shkaktuar nga koronavirusi mund të identifikohen disa narrativa kryesore të ngjashme me ato që qarkulluan edhe në shtypin botëror. Media shqiptare u dha hapësirë fillimisht teorive që fokusoheshin mbi origjinën e virusit. Në fillimet e pandemisë disa media publikuan lajme që flisnin për një treg në provincën Wuhan të Kinës ku u përhap për herë të parë koronavirusi.⁹

Në kuadër të narrativës mbi origjinën e virusit, një nga teoritë konspirative më të përhapura në mediat shqiptare ishte lidhja që i bëhej teknologjisë 5G me përhapjen e koronavirusit.

Promovuesit e kësaj teorie pretendonin se rrjetet 5G dobësojnë sistemet imunitare. Për ta bërë më të besueshme teorinë e tyre ata keqpërdorën teorinë e nobelistit francez Luc Montagnier, sipas se cilës bakteret mund të gjenerojnë vale radioje. Për më tepër, raportohet se një regjistrim zëri ka qarkulluar në të gjithë botën në fund të marsit, ku një person

⁹ “Publikohen fotot e tregjeve në Kinë/ Gjarpërinjtë, lakuriqët e natës dhe minjtë përhapësit kryesorë të koronavirusit në Wuhan”, 26 January 2020. <https://dosja.al/dosja-kine-12/>

që e paraqiti veten si ish-drejtor i një kompanie të madhe telekomunikacioni paralajmëroi që COVID-19 është pjesë e një komploti global për të instaluar 5G në telefonat celularë, për të monitoruar popullsinë botërore përmes vaksinimeve dhe për të shkatërruar shoqërinë njerëzore. Sipas “The Guardian”, u zbulua se zëri i përkiste një predikuesi nga Lutoni, Jonathon James.¹⁰ Nga monitorimi i medias vihet re se disa portale publikuan lajme me këtë tematikë.^{11,12}

Narrativa e dytë kryesore lidhet me lajmet e rreme dhe teoritë konspirative që e paraqesin virusin si një mashtrim, apo si diçka të zakonshme me gripin sezonal. Në këtë grup hasen shpesh lajme që kanë në thelb idenë se situata e koronavirusit hiperbolizohet nga qeveri apo grupe të caktuara për interesat e tyre.

Mekalimin e kohës, media filloi të fokusohet te narrativat në lidhje me vaksinën, efikasitetin, teknologjinë me të cilën ishin prodhuar dhe efektet anësore të tyre. Në kuadër të kësaj narrative, e cila është mbizotëruese ende në raportimet e medias, identifikohen disa dezinformacione si:

¹⁰ “Revealed: ‘former Vodafone executive’ in 5G conspiracy video is UK pastor”, 24 April 2020. <https://www.theguardian.com/world/2020/apr/24/vodafone-exec-5g-koronavirus-conspiracy-theory-video-revealed-pastor-luton-jonathon-james>

¹¹ <https://kohajone.com/a-lidhet-teknologjia-5g-me-perhapjen-e-koronavirusit-ne-britani-njerezit-sulmojne-antenat/>

¹² <https://gazetasi.al/perse-po-spekulohet-kaq-shume-per-lidhjen-mes-rrjetit-5g-dhe-koronavirusit/>
<http://www.gazetatema.net/2020/04/26/koronavirus-dhe-5g-ky-eshte-truri-pas-teorive-te-komplotit/>

- “Vaksina shkakton ndryshime gjenetike, “
- “Vaksina COVID është një formë eutanazie, ata që i nënshtrohen vaksinimit do të vdesin pas një viti,”
- “Vaksinat rrisin numrin e homoseksualëve, pasi ato devijojnë gjenet,”
- “Vaksina shkakton sterilitet dhe ju pengon të lindni fëmijë.”

Këto pretendime gjejnë pasqyrim në disa televizione, kryesisht përmes deklaratave nga të ftuarit në programe të ndryshme. Një nga televizionet që i ka kushtuar një hapësirë të konsiderueshme personave që mbrojnë idetë konspirative është Top Channel. Rubrika e titulluar “Rrethi Katror”, pjesë e spektaklit televiziv “E diell”, e cila transmetohet në këtë kanal televiziv, ka të ftuar të përhershëm z. Alfred Cako, i cili është i njohur për qëndrime e tij pro ideve konspirative.

Në rubrikën e datës 5 dhjetor 2020, Cako deklaronte se “Vetë vaksinat do të jenë një lloj eutanazie por me efekt më të gjatë prej një viti. Në 10 muaj ato do të japin një efekt edhe qetësues. Më pas vaksina do të bëhet me moshë, nga 50-55 do të sterilizohen dhe më pas një pjesë e popullsisë do të zhduket. Do të ketë reduktim të popullsisë të njerëzve në botë”.

Kjo deklaratë gjeti pasqyrim një ditë më pas në portalin e lidhur me këtë televizion, shoqëruar me titullin “Çudit Alfred Cako: Vaksina e COVID është një formë eutanazie, ata që do ta bëjnë vdesin pas një viti”¹³. I

¹³ “Çudit Alfred Cako: Vaksina e COVID është një formë eutanazie, ata që do ta bëjnë vdesin pas një viti”, 6 April, 2020. <https://top-channel.tv/2020/12/06/cudit-alfred-cako-vaksina-e-covid-eshte-nje-forme-eutanazie-ata-qe-do-ta-bejne-vdesin-pas-nje-viti/>

njëti personazh i ftuar në emisionin “ABC e pasdites” në televizionin ABC deklaronte se “ Pandemia do fusë Europën në kaos”.¹⁴

Videot e programeve televizive të postuara në rrjetet sociale, gjenerojnë një numër shumë të madh angazhimesh (pëlqime, rishpërndarje, komente dhe klikime) nga përdoruesit. Në analizën e BIRN, referuar platformës “Crowdtangle” për një video të televizionit “Oranews”, publikuar në faqen e Facebook, vihet re se “nga data 1 maj 2020, kjo video ka marrë më shumë se 477 mijë shikime dhe ka gjeneruar më shumë 6871 ndërveprime, ku përfshihen komentet, pëlqimet dhe ikonat ‘emoji’ që shprehin emocione”.¹⁵

Konkurrenca globale nga prodhuesit e vaksinave përbën një tjetër tematikë kryesore që mbizotëron në raportimet e mediave shqiptare. Lajmet që trajtonin efikasitetin e markave të ndryshme të vaksinës janë më se të zakonshme në portalet e lajmeve dhe llogarite e tyre në rrjetet sociale. Në një lajm të publikuar më 3 prill 2021, portali Balkanweb botoi një lajm duke iu referuar gazetës “New York Times”, ku flitej për një renditje të vaksinave kryesore sipas efektshmërisë.

¹⁴ “Pandemia do të fusë Europën në kaos. Alfred Cako në ‘Abc e pasdites’: Nuk do e besoni çfarë do të ndodhë”, July 15, 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=jPoo6fFHBfQ>

¹⁵ “Televizionet i shtruan ‘tapetin e kuq’ teorive konspirative kundër vaksinave”, 14 September 2021. https://www.reporter.al/televizionet-i-shtruan-tapetin-e-kuq-teorive-konspirative-kunder-vaksinave/?fbclid=IwAR2OZwPIXfYFZnEXsywICVA_td5L9hjaH2R3QH7Qn9ez5h4Css-9DP7rb1Y

Lajmi u publikua me titullin “*New York Times*” rendit vaksinat sipas efektshmërisë: *Coronavac e Sinovac 83.5% efektive në luftën kundër virusit*”.¹⁶

Në lajm thuhej se katër vaksinat kineze renditen në krye duke lënë pas të gjitha markat e tjera të prodhuara në vendet perëndimore. Më vonë ky lajmi të cilit i referohej “Balkanweb” u verifikua nga shërbimi i verifikimit të fakteve të agjencisë AFP.¹⁷

Sipas raportimit të AFP artikulli u klasifikua si lajm i rremë. Verifikimi i lajmit si i rremë gjeti mbulim në disa media, të cilat vunë në dukje se artikulli të cilin e kishte përmendur kryeministri Edi Rama për të promovuar efikasitetin e vaksinës që kishte siguruar qeveria për popullatën, ishte i rremë.¹⁸

Krahas problematikës së publikimit të lajmeve bazuar në teori konspirative dhe lajme të rreme, në disa raste,

¹⁶ ““*New York Times*” rendit vaksinat sipas efektshmërisë: *Coronavac e Sinovac 83.5% efektive në luftën kundër virusit*”, 3 April 2021. <https://www.balkanweb.com/new-york-times-rendit-vaksinat-sipas-efektshmerise-coronavac-e-sinovac-83-5-efektive-ne-luften-kunder-virusit/>

¹⁷ “Misleading posts circulate online claiming that NYT, Deutsche Welle endorsed China’s Covid-19 vaccines”, 12 March 2021. <https://factcheck.afp.com/misleading-posts-circulate-online-claiming-nyt-deutsche-welle-endorsed-chinas-covid-19-vaccines?fbclid=IwAR3IpQ8GGSPaaGs63Twfabpb6yIRw9LueytXOFAjlu8PFH7kNvAujlj3sxo>

¹⁸ “Vaksina kineze, e vërteta e artikullit të *New York Times* që përmendi Rama. AFP e klasifikon si lajm të rremë”, 03 April, 2021. <https://lapsi.al/2021/04/03/vaksina-kineze-e-verteta-e-artikullit-te-new-york-times-qe-permendi-rama-afp-e-klasifikon-si-lajm-te-rreme/>

media të caktuara i kushtuan rëndësi dhe raportimit të dukurisë së dezinformacionit gjatë periudhës së pandemisë. Në disa media u publikuan lajme që kishin si temë përhapjen dhe rrezikun që mbartnin teoritë konspirative dhe lajmet e rreme në lidhje me vaksinat dhe virusin.¹⁹

Disa prej këtyre informacioneve i referoheshin edhe studimeve apo analizave të mediave ndërkombëtare, të cilat e trajtuan gjerësisht këtë temë.²⁰ Kjo sjellje e një pjese të medias shqiptare tregon se raportimi i përgjegjshëm dhe profesionist i ngjarjeve me përmasa të tilla, si kriza e koronavirusit, është e mundur.

¹⁹ “Rritja e teorive të komplotit rrezikon të minojë demokracinë e brishtë në Ballkan”, 14 Aug 2020. <https://www.reporter.al/rritja-e-teorive-te-komplotit-rrezikon-te-minoje-demokracine-e-brishte-ne-ballkan/>

²⁰ “Qanon bëhet evropiane”, 23 October 2020. <https://gazetamapo.al/qanon-behet-evropiane/>

Këndvështrime mbi zgjidhjen e problemit

Shqetësimi i madh i krijuar nga përhapja masive e lajmeve të rreme dhe teorive konspirative, sidomos gjatë periudhës së pandemisë ka tërhequr vëmendjen në drejtim të gjetjes së zgjidhjeve. Studime dhe analiza të shumta janë kryer për të kuptuar se si mund t'ia dalim mbanë në betejën me dezinformimin. Alternativat e ofruara variojnë, nga masat parandaluese deri tek ato për reduktimin e efektit të dezinformacionit.

Në shumicën e studimeve, pyetja kryesore që shtrohet është: Si mund ta zgjidhim problemin e dezinformimit dhe si mund të mbrojmë qytetarin nga pasojat e tij? Modelet e ofruara nga shumë studiues përqendrohen në dy qasje kryesore për adresimin e problemit. Një pjesë e kërkuesve dhe profesionistëve janë përqendruar në kritikën ndaj rolit të rrjeteve sociale si Facebook, Twitter së bashku me motorët e kërkimit si Google, ndërkohë shumë të tjerë këmbëngulin në nevojën urgjente për rritjen e nivelit të edukimit mediatic, si një alternativë që mund të ndihmojë audiencat të zhvillojnë aftësinë për të analizuar informacionin që aksesojnë në rrjet (Jones-Jang, Mortensen and Liu 2019).

Nëse këto dy qasje do t'i zbërthenim më në detaje, atëherë na shfaqet një model zgjidhje që bazohet në tre

hapa. Hapi i parë ka të bëjë me rritjen e kapaciteteve njohëse dhe vlerësuese të audiencës. Kjo do të thotë të ndihmohet përdoruesit e internetit të modifikojnë zakonet e tyre në internet për të minimizuar mundësinë që ata të formojnë besime të rreme të ndikuara nga lajmet e rreme dhe propaganda. Ky hap ka të bëjë direkt me edukimin mbi median dhe informacionin, dhe përbën një alternativë zgjidhjeje që kërkon kohë dhe burime të konsiderueshme por që ofron më shumë garanci.

Hapi i dytë lidhet me një qasje vetë-rregulluese që kërkon përfshirjen e një sërë aktorësh, duke nisur së pari nga vetë korporatat e medias sociale dhe motorët e kërkimit në internet. Në këtë pikë kemi të bëjmë me angazhimin e këtyre korporatave në modifikimin e programeve dhe algoritmave që qëndrojnë pas faqeve. Ndërsa një hap i tretë nënkupton ndërhyrjet rregullatore nga qeveritë dhe institucionet në varësi të tyre, për të miratuar ligje dhe rregulla të cilat parashikojnë masa, si për korporatat e internetit, ashtu edhe për individët që me dashje përfshihen në fushata dezinformuese (Brown 2021).

Ndërkohë një model tjetër i propozuar për adresimin e problemit bazohet në zgjidhje që mund të grupohen në katër kategori: (1) algoritmike, (2) korigjuese, (3) legjislative dhe (4) psikologjike (Linden and Roozenbeek 2021). Në kategorinë e parë, ashtu si në qasjen vetërregulluese të përmendur më lart, përfshihen përpjekjet e platformave si Google dhe Facebook, të cilat që pas shqetësimit për ndikimin

e lajmeve të rreme në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në SHBA, kanë intensifikuar përpjekjet për përshtatjen e algoritmeve të tyre në mënyrë që ato të mos favorizojnë shpërndarjen e lajmeve të rreme.

Ndërhyrjet në algoritmet kompjuterike synojnë të parandalojnë ekspozimin e përdoruesve ndaj dezinformimit në të njëjtën shkallë, siç ndodh me lajmet që shpërndahen nga burime të besueshme dhe të verifikuara. Megjithatë mungesa e transparencës për këto ndërhyrje në algoritme dhe shqetësimi mbi fuqinë në rritje të korporatave të mëdha në kontrollin e rrjedhës së informacionit, kanë ngritur shumë pikëpyetje në komunitetin e studiuesve (Çela and Tufa 2021). Periudha e pandemisë ka treguar se ndërhyrje të tilla nga njëra anë kanë qenë të pamjaftueshme për të parandaluar ritmin e përhapjes së teorive konspirative dhe lajmeve të rreme dhe nga ana tjetër kanë shtuar shqetësimet për censurë në rrjet.

Kategoria e dytë përfshin iniciativat për verifikimin e fakteve. Në shumë vende të botës veprojnë organizata mediatike dhe grupime të ndryshme profesionistësh që merren me verifikimin e fakteve në lajmet e publikuara. Po kështu edhe organizmat ndërkombëtare si Bashkimi Europian, Organizata e Kombeve të Bashkuara, etj., kanë krijuar platforma të posaçme për verifikimin e informacionit dhe demaskimin e informacioneve të rreme. Në këtë rast kemi të bëjmë me një qasje korrektuese, çka nënkupton se një veprim ndërmerret pasi informacioni është shpërndarë. Kjo do të thotë se korrigjimi me anë të metodave të verifikimit të fakteve

nuk ka angazhim prapaveprues dhe nuk parandalon ndikimin që ka lajmi i rremë tek audienat.

Aksionet korrektuese mund të ndihmojnë në reduktimin e dëmit që shkaktojnë këto informacione tek audienat dhe në identifikimin e burimeve që i përhapin ato. Megjithatë, mbetet shumë e vështirë të verifikohet dhe demaskohet çdo informacion i rremë që qarkullon në rrjet. Kjo është një betejë që kërkon burime të shumta njerëzore, teknologjike dhe financiare. Ndërkohë që është provuar tashmë se lajmet e rreme përhapen shumë më shpejt se informacioni i vërtetë. Lajmi i rremë mund të përhapet deri në gjashtë herë më shpejt sesa një lajm i vërtetë (Vosoughi, Roy and Aral 2018). Nisur nga këto fakte, është e vështirë të thuhet se kjo betejë e shoqërisë me dezinformacionin mund të fitohet përmes iniciativave të tilla.

Ndërhyrjet legislative propozohen si një rrugë përmes së cilës mund të ndërhyhet në zgjidhjen e problemit. Disa shtete në Europë kanë hedhur hapa në këtë drejtim duke miratuar ligje të posaçme. Pavarësisht këtyre ligjeve, është vënë re se ndërhyrjet nga jashtë në ekosistemin e medias dhe informacionit mund të mos prodhojnë gjithmonë efektin e dëshiruar. Kjo është vërtetuar tashmë në disa prej këtyre vendeve që kryejnë ndërhyrje të tilla ligjore dhe rregullatore. Franca dhe Britania e Madhe janë dy vende që ndërmorën nisma ligjore për parandalimin e dezinformimit.

Në të dyja vendet ka patur një debat intensiv në lidhje me hapësirën që i jep korniza e re ligjore qeverisë për të ushtruar censurë mbi informacionin dhe,

për rrjedhojë, për të dëmtuar lirinë e informimit të qytetarëve (Smith 2019). Shqetësimi i ngritur nga organizatat e medias, shoqërisë civile dhe gazetarët mund të përblidhet në ndikimin negativ që mund të ketë zgjerimi i kompetencave të qeverive për të vlerësuar saktësinë dhe vërtetësinë e informacionit. Këto kompetenca mund t'i japin dorë të lirë politikës të ndërhyjë në të drejtat e publikut për informacion dhe mund të lejojnë përfitime të njëanshme të grupeve politike, duke etiketuar si dezinformacione të gjitha lajmet që nuk shkojnë për shtat me axhendën e tyre.

Në grupin e fundit përfshihen përpjekjet fokusohen të rritja e aftësive të përdoruesve të medias për të identifikuar dhe shmangur informacione e rreme, konspiracionet , apo format e tjera të dezinformimit. Ashtu si në modelin e parë, kjo qasje mbështet në edukim. Megjithatë, si në çdo rast edukimi është një proces i gjatë dhe mjaft kompleks. Audiencat janë shumë diverse dhe përbëhen nga njerëz që kanë preferenca, rutina të ndryshme në lidhje me përdorimin e medias dhe konsumin e informacionit.

Edukimi mbi median dhe informacionin, e parë si një zgjidhje për adresimin e problemit të dezinformacionin po gjen mbështetje kohët e fundit. Pandemia ka rizgjuar edhe një herë vëmendjen e të gjithëve drejt kësaj qasjeje. Edukimi dhe rritja e aftësisë në drejtim të vlerësimit kritik të përmbajtjes, perceptohet si një formë imunizimi e audiencave përballë konspiracioneve dhe lajmeve të rreme. Modeli i propozuar, është bazuar në teorinë e inokulimit, e cila mbështetet në parimin e ndërtimit

të rezistencës ndaj mesazheve të padëshiruara. Pyetja në këtë rast shtrohet: a është e mundur që audienca të pajiset me mburojë imuniteti përballë lajmit të rremë, konspiracioneve dhe propagandës? A funksionon kjo teori në kontekstin e dezinformimit masiv në mediat sociale dhe internet?

Imunizimi i audiencave përmes edukimit mediatik

Studiuesi amerikan William J. McGuire ishte i pari që hodhi idenë e imunizimit të audiencës. Teoria e tij e inokulimit (imunizimit), ofron një model për ndërtimin e rezistencës ndaj përpjekjeve për të bindur njerëzit, duke i ekspozuar ata ndaj argumenteve kundër besimeve dhe qëndrimeve të tyre. Teoria synon t'u ofrojë individëve kundërargumente për të hedhur poshtë këto orvatje për bindjen dhe ndryshimin e opinionit. McGuire përdori analogjinë e imunizimit ndaj sëmundjeve përmes vaksinave. Ai mendonte se ashtu siç ndodh me vaksinimin biologjik, i cili zhvillon rezistencë ndaj viruseve duke injektuar një version të dobësuar të agjentit viral në trup, duke shkaktuar prodhimin e antitropave, mund të veprohet në krijimin e një imunizimi të sjelljes. Njerëzit mund të ekspozohen ndaj një mesazhi që përmban një “rrezik të dobësuar”, duke nxitur reagimin dhe forcuar qëndrimin motivues dhe rezistencën përpara një mesazhi me rrezikshmëri të lartë. (Compton and Pfau 2009).

Ndërsa Michael Pfau e zgjeroi modelin teorik duke e përshtatur për audiencat që janë të ekspozuara ndaj fushatave dhe mesazheve politike (Pfau 1988). Përshtatja e qasjes së McGuire ka vazhduar edhe pas viteve 2000. Pas debatit që shkaktuan fushatat e

dezinformimit në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në SHBA, dhe sidomos gjatë pandemisë, është rritur vëmendja e studiuesve ndaj kësaj teorie. Tashmë po flitet gjithmonë e më shumë për edukimin mbi median dhe informacionin si një alternativë që mund të ndihmojë në luftën kundër lajmeve të rreme.

Studimet tregojnë se qëndrimet e publikut mund të “imunizohen” në mënyrë efektive kundër ndikimit të dezinformacionit (Linden, Leiserowitz, et al. 2017). Ndonëse në miniaturë, modeli u testua edhe në kontekstin e audiencave shqiptare. Një studim i kryer me dy grupe të ndryshme studentësh vërtetoi se edukimi mbi median dhe informacionin ofron njohuri të mira për të analizuar tipologjitë e informacionit në internet. Hulumtimi mori në analizë efektin e leksioneve mbi edukimit medial të grupit të parë i studentëve, duke kërkuar diferencën që ky grup kishte më studentët e tjerë të cilët nuk kishin marrë asnjë njohuri në këtë fushë.

Nga analiza e gjetjeve u vu re se studentët pjesëmarrës në ciklin e leksioneve mbi edukimin mediatik kishin njohuri shumë më qarta mbi konceptet e lartpërmendura; arrinin të dallonin diferencën mes koncepteve dhe të tregonin aftësi të mira në përkufizimin e termave të tillë si “fake news”, “teori konspirative”, “propagandë”, etj. Studentët e këtij grupi kishin ide të qarta mbi efektin që ka edukimi mediatik në mënyrën se si ata e ndërtojnë raportin me mediat. (Çela and Tufa 2021)

Pavarësisht të dhënave nga ky studim, është e rëndësishme që përpara se të ecet në drejtim të përgatitjes së strategjive dhe politikave për edukimin mbi median dhe informacionin, të kryen hulumtime më të thelluara në drejtim të efikasitetit që ofron qasja e imunizimit të audiencave në betejën me dezinformacionin. Mbetet e nevojshme që të testohet ky model në kategori të ndryshme të audiencës, duke synuar një nivel përfaqësimi më të lartë.

Përfundime dhe rekomandime

Nisur nga kompleksiteti i problemit të dezinformimit, mund të dilet në përfundimin se nuk ekziston një qasje të vetme që garanton sukses në betejën kundër dezinformimit me të gjitha format që ai shfaqet. Kombinimi i shumë mënyrave dhe përfshirja e integruar e aktorëve nga bota akademike, profesionistët e medias, korporatat dhe politikbërësit mund të sjellë një rezultat të qëndrueshëm në përballimin e kësaj sfide. Përhapja e teorive konspirative me fokus pandeminë e koronavirusit dhe vaksinimin përbën një rrezik serioz për shoqërinë. Në rastin e Shqipërisë duket se prania e lajmeve të rreme apo teorive konspirative dhe përhapja e tyre si në mediat tradicionale ashtu dhe në rrjetet sociale, ka ndikuar në perceptimin e publikut mbi vaksinën dhe pandeminë në përgjithësi.

Të dhënat e sondazheve dhe studimeve në Shqipëri dhe rajon, të realizuara në kohë të ndryshme, tregojnë një shkallë të lartë të besimit të shqiptarëve tek teoritë konspirative dhe lajmet e rreme. Efekti i qarkullimit të dezinformacioneve në median sociale amplifikohet ndjeshëm kur mediat konvencionale i japin hapësirë individëve që promovojnë këto ide.

Analiza e diskursit mediatik na tregon se disa media audiovizive dhe portale kanë shërbyer si përhapëse

të konspiracioneve dhe gjysmë të vërtetave në lidhje me pandeminë dhe vaksinat. Rastet e monitoruara tregojnë se një pjesë e portaleve informative, botojnë informacione të marra nga burime të huaja por që shpesh nuk verifikohen për vërtetësinë e tyre. Media zgjedh t'i shoqërojë këto lajme me tituj sensacionalë që ndihmojnë në rritjen e angazhimit të përdoruesve me përmbajtjen.

Të tërhequr nga të dhënat analitike për angazhimin e përdoruesve me lajmin, mediat anashkalojnë një sërë normash dhe parimesh deontologjike dhe etike. Gara për vëmendjen e audiencës ka përfshirë ndjeshëm dhe mediat tradicionale, veçanërisht televizionet të cilat krahas portaleve informative, janë bërë përhapëse dhe lejuese të konspiracioneve.

Duket se qasja në spektrin mediatik shqiptar nuk ka një nxitje ideologjike për përhapjen dhe promovimin e teorive konspirative. Mediat nuk nisen nga qëndrime të qarta ideologjike. Ato më shumë janë të shtyra nga ideja për të tërhequr më shumë audiencë, duke e parë angazhimin e shtuar me këto informacione si një burim për të rritur të ardhurat. Megjithatë vihet re një sjellje e gabuar për t'i diskutuar temat që lidhen me pandeminë dhe vaksinat në kontekstin e debatit politik.

Media të ndryshme që kanë politika të qarta redaksionale pro qeverisë apo pro opozitës e kanë trajtuar temën e vaksinimit nisur nga pozicioni që ato kanë me kahe të ndryshme të politikës. Mbulimi në këtë formë i ngjarjeve që lidhen me pandeminë,

trajtimin e të sëmurëve dhe vaksinimin, ka shtuar shkallën e polarizimit në publik. Kjo dukuri ka qenë më e pranishme gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e 25 prillit. Një tjetër problematikë e vërejtur është organizimi i debateve televizive duke përfshirë në panele profesionistë të fushës së mjekësisë dhe individë pa formim përkatës në këtë fushë. Kjo ka prodhuar një debat të pabalancuar duke çuar shpesh në relativizimin e fakteve dhe duke e lënë audiencën të painformuar mbi atë çka po ndodh me pandeminë dhe vaksinat. Kompozimi i paneleve me një shkallë kaq të lartë polarizimi dhe disbalance në ekspertizë mund të ketë prodhuar më shumë spektakël, por nuk ka shërbyer për të informuar profesionalisht publikun.

Kjo situatë kërkon një vëmendje të shtuar të aktorëve mediatikë, sidomos të gazetarëve dhe drejtuesve të redaksive. Organizimi i tryezave profesionale diskutimi që të marrin në analizë këtë sjellje të medias, mund të jetë hapi i parë për të korrigjuar problematikën. Krizat e mëdha si kjo e pandemisë së koronavirusit krahas sfidave që sjellin për gazetarinë profesioniste, ofrojnë dhe mundësi për reflektuar mbi profesionin dhe marrëdhënien e audiencës. Ndërkohë roli i disa mediave që janë fokusuar në analiza të thelluara dhe verifikimin e fakteve mbetet i rëndësishëm në kuadër të një qasjeje të integruar të aktorëve për parandalimin e fushatave të dezinformimit dhe pasojave që ato sjellin në shoqëri.

Ashtu siç u përmend edhe më lart, problemi i dezinformimit kërkon një angazhim shumë më të

organizuar të institucioneve publike dhe mediave në drejtim të edukimit të audiencave mbi median dhe informacionin. Por përpara se të angazhohemi në edukimin e audiencave, është thelbësore që institucionet publike, sidomos ato të përfshira direkt në menaxhimin e pandemisë, të rrisin transparencën me median dhe publikun.

Transparenca më e lartë e institucioneve do të sjellë më shumë besim të qytetarëve tek ato. Si rezultat do të kemi më pak njerëz të painformuar, të cilët e plotësojnë këtë nevojë nga burime të dyshimta. Sa më i ulët të jetë besimi i publikut të mediat, qeveria dhe shkenca, aq më i lartë është besimi tek konspiracionet dhe informacionet e manipuluar. Teoritë konspirative, lajmet e rreme dhe propaganda lulëzojnë në terr informativ dhe mungesë transparence.

Edukimi mbi median dhe informacionin i audiencave mbetet alternativa më e qëndrueshme për përballimin e dezinformimit. Raportet ndërkombëtare tregojnë së Shqipëria është një nga vendet me nivel më të ulët të edukimit mediatic. Kjo situatë krijon terren pjellor për përhapjen konspiracioneve, lajmeve të rreme dhe propagandës. Besimi i lartë i shqiptarëve tek teoritë konspirative mbi vaksinat dhe koronavirusin tregon qartazi se kemi të bëjmë me një shoqëri që e ka të vështirë të ndajë faktet nga informacionet e fabrikuara. Konsumatori i informacionit dhe përmbajtjes nuk ka njohuritë dhe kapacitete e duhura për të vlerësuar në mënyrë kritike burimin e informacionit dhe produktin që i serviret.

Nisur nga ky përfundim rekomandohet një angazhim më i lartë në hartimin e politikave dhe strategjive për edukimin qytetarëve mbi median dhe informacionin. Përfitimi nga një audiencë e edukuar mirë, nuk lidhet vetëm me përballimin e dezinformacionit. Qytetari i informuar mbi mënyrën si funksionon media, procesin e prodhimit të lajmit, pronësinë dhe çështje të tjera është padyshim më i mbrojtur nga manipulimi në përgjithësi. Ai ka mundësi të bëjë vlerësime bazuar në fakte dhe të marrë vendime të drejta.

Literatura

- Allcott, Hunt, and Matthew Gentzkow. 2017. "Social Media and Fake News in the 2016." *Journal of Economic Perspectives, Volume.31, NO.2* 211–236.
- BELTON, DANIELLE. 2021. "How Journalism Moves Forward in an Age of Disinformation and Distrust." *Nieman Reports*, September 21.
- Bieber, Florian. 2020. *Teoritë konspirative dhe mashtrimet në Ballkan*. Graz, July 8.
- Bieber, Florian, Tena Prelec, Dejan Jovic, and Zoran Nechev. 2021. *Virusi i dyshimtë: Konspiracionet dhe Covid-19 në Ballkan*. Graz: Balkans in Europe Policy Advisory Group (BiEPAG).
- Bogdani, Nensi. 2020. *Aktivistët kundër vaksinave të COVID-19 dhe 5G-së protestojnë në Tiranë*. June 2. Accessed September 10, 2021. <https://www.reporter.al/aktivistet-kunder-vaksinave-te-covid-19-dhe-5g-se-protestojne-ne-tirane/>.
- Brennen, J. Scott, Felix Simon, Philip N. Howard, and Rasmus Kleis Nielsen. 2020. *Types, sources, and claims of COVID-19 misinformation*. Oxford, April 7.
- Broersma, Marcel, and Joëlle Swart. 2021. "Do Novel Routines Stick After the Pandemic? The Formation of News Habits During COVID-19." *Journalism Studies* 1-19.
- Brown, Étienne. 2021. "Regulating the Spread of Online Misinformation." In *The Routledge Handbook of Political Epistemology*, by Michael Hannon and Jeroen de Ridder, 214-225. New York: Routledge.

- Butter, Michael, and Peter Knight. 2020. *Routledge handbook of conspiracy theories*. New York: Routledge.
- Çela, Erlis. 2020. *Covid -19 in the Media Between fake news and conspiracy theories*. Tirana: Albanian Media Institute.
- Çela, Erlis, and Alban Tufa. 2021. «Edukimi mediatic si strategji për imunizimin e audiencave përballë lajmeve të rreme dhe teorive konspirative.» *Perspectives on Covid-19: Challenges, Solutions, and Opportunities*. Tirana: Beder University. 13-39.
- Compton, Josh, and Michael Pfau. 2009. "Spreading Inoculation: Inoculation, Resistance to Influence, and Word-of-Mouth Communication." *Communication Theory* 9–28.
- Compton, Josh, Sander van der Linden, John Cook, and Melisa Basol. 2021. "Inoculation theory in the post-truth era: Extant findings and new frontiers for contested science, misinformation, and conspiracy theories." *Soc Personal Psychol Compass* 1-16.
- Douglas, Karen M., Robbie M. Sutton, and Aleksandra Cichocka. 2017. "The Psychology of Conspiracy Theories." *Association for Psychological Sciences Vol. 26*(6 538–542).
- Fletcher, Richard, Alessio Cornia, Lucas Graves, and Rasmus Kleis Nielsen. 2018. *Measuring the reach of "fake news" and online disinformation in Europe*. Oxford, February .
- Giusti, Serena, and Elisa Piras. 2021. *Democracy and Fake News. Information Manipulation and Post-Truth Politics*. New York: Routledge.
- Ireton, Cherilyn, and Julie Posetti. 2018. *Journalism, "Fake news" & Disinformation: Handbook for Journalism Education and Training*. Paris: UNESCO.
- Jones-Jang, S. Mo, Tara Mortensen, and Jingjing Liu. 2019. "Does Media Literacy Help Identification of Fake News? Information Literacy Helps, but Other Literacies Don't." *American Behavioral Scientist* 1-18.

Jr, Edson C. Tandoc, Zheng Wei Lim, and Richard Ling. 2018. "Defining "Fake News", A typology of scholarly definitions." *Digital Journalism* 137-153.

Kanoh, Hiroko. 2018. "Why do people believe in fake news over the Internet?" *Procedia Computer Science* 1704-1709.

Levy, Neil. 2017. "The Bad News About Fake News." *Social Epistemology Review and Reply Collective* 20-36.

Levy, Neil, and Robert M. Ross. 2021. "The Cognitive Science of Fake News." In *The Routledge Handbook of Political Epistemology*, by Michael Hannon and Jeroen de Ridder, 181-191. New York: Routledge.

Likmeta, Besar. 2020. *Si u bënë virale lajmet e rreme për pandeminë e COVID-19 në Shqipëri*. Tirana, October 22.

Likmeta, Besar. 2021. *Televizionet i shtruan 'tapetin e kuq' teorive konspirative kundër vaksinave*. Tirana, September 14.

Linden, Sander van der, and Jon Roozenbeek. 2021. "Psychological inoculation against fake news." In *The Psychology of Fake News*, by Rainer Greifeneder, Mariela E. Jaffé, Eryn J. Newman and Norbert Schwarz, 147-169. New York: Routledge.

Linden, Sander van der, Anthony Leiserowitz, Seth Rosenthal, and Edward Maibach. 2017. "Inoculating the Public against Misinformation about Climate Change." *Global Challenges* 1-7.

Marwick, Alice E. 2018. "Why do people share Fake News? A sociotechnical model of Media Effects." *Georgetown Law Technology Review* 474-512.

Michael J. Wood, Karen M. Douglas, and Robbie M. Sutton. 2012. "Dead and Alive: Beliefs in Contradictory Conspiracy Theories." *Social Psychological and Personality Science* 767-773.

- Panorama, Gazeta. 2021. *Raporti i SHISH: Situata e COVID-19 u shfrytëzua nga aktorë jo-perëndimorë, për të përhapur euro-skepticizmin*. Tirana, August 17.
- Pennycook, Gordon, and David G. Rand. 2021. "The Psychology of Fake News." *Trends in Cognitive Sciences* 388-402.
- Pfau, Michael. 1988 . "Inoculation in Political Campaign Communication." *Human Communication Research Vol. 15 No. 1* 91-111.
- Research, Idra. 2020. *COVID-19, VAKSINA DHE TEORITË KONSPIRATIVE MBI TË*. Tiranë, October 10.
- Roozenbeek, Jon, and Sander van der Linden. 2019. "Fake news game confers psychological resistance against online misinformation." *Palgrave Communications* 1-10.
- Senja, Emirjon. 2021. *Mes frikës dhe skepticizmit mbi pandeminë, një analizë e sjelljes së audiencës shqiptare në Facebook*. Tirana, September 24.
- Smith, Rachael Craufurd. 2019. "Fake news, French Law and democratic legitimacy: lessons for the United Kingdom?" *Journal of Media Law* 52-81.
- Talwara, Shalini, Amandeep Dhirb, Puneet Kaurc, Nida Zafare, and Melfi Alrasheedyf. 2019. "Why do people share fake news? Associations between the dark side of social media use and fake news sharing behavior." *Journal of Retailing and Consumer Services* 72-82.
- Tambini, Damian. 2017. *Fake News: Public Policy Responses*. Media Policy Brief 20, London, March.
- Tandoc, Edson C, Zheng Wei Lim, and Richard Ling. 2018. "Defining "Fake News", A typology of scholarly definitions." *Digital Journalism* 137-153.
- Titcomb, James, and James Carson. 2018. *telegraph.co.uk*. January 29. Accessed February 10, 2018. <http://www>.

telegraph.co.uk/technology/0/fake-news-exactly-has-really-had-influence/.

Todor Hristov, Andrew McKenzie-McHarg, and Alejandro Romero-Reche. 2020. "Definitions and approaches." In *Routledge Handbook Of Conspiracy Theories*, by Michael Butter and Peter Knight, 11-15. New York: Routledge.

Uscinski, Joseph E. 2019. "What is a Conspiracy Theory?" In *Conspiracy Theories and the People Who Believe Them*, by Joseph E. Uscinski, 47-52. New York: Oxford University Press.

Uscinski, Joseph E., Adam M. Enders, Casey A. Klofstad, Michelle I. Seelig, John, R. Funchion, and Caleb Everett. 2020. "Why do people believe COVID-19 conspiracy theories?" *The Harvard Kennedy School (HKS) Misinformation Review, Volume 1* 1-12.

Vosoughi, Soroush, Deb Roy, and Sinan Aral. 2018. "The spread of true and false news online." *Science* 1146–1151.

Winston, Brian, and Matthew Winston. 2021. *The Roots of Fake News. Objecting to Objective Journalism*. New York: Routledge.

Gruzd Anatoliy; Mai Philip, "Going viral: How a single tweet spawned a COVID-19 conspiracy theory on Twitter", *Big Data & Society*, P: 1–9, July–December 2020

Bruns, Axel, Stephen Harrington and Edward Hurcombe. 2020. "Corona? 5G? or both?' the dynamics of COVID-19/5G conspiracy theories on Facebook", *Media International Australia*, 1–18.

Motta, Matt, Stecula, Dominik, and Farhart, Christina. 2020. "How Right-Leaning Media Coverage of COVID-19 Facilitated the Spread of Misinformation in the Early Stages of the Pandemic in the U.S.", *Canadian Journal of Political Science*, 53, 335–342

Eeas Special Report: Disinformation On The Koronavirus – Short Assessment Of The Information Environment”, MARCH 19, 2020.<https://euvsdisinfo.eu/eeas-special-report-disinformation-on-the-koronavirus-short-assessment-of-the-information-environment/>

Lopez, German. 2016. “Pizzagate, the fake news conspiracy theory that led a gunman to DC’s Comet Ping Pong, explained”, <https://www.vox.com/policy-and-politics/2016/12/5/13842258/pizzagate-comet-ping-pong-fake-news>

M. Douglas, Karen, M. Sutton, M. Sutton Robbie, and Aleksandra Cichocka. 2017. “The Psychology of Conspiracy Theories”, , Association for Psychological Sciences, Vol. 26(6) 538–542

M. Douglas, Karen. 2019. “Understanding Conspiracy Theories”, *Advances in Political Psychology*, Vol. 40, Suppl.

J. Scott Brennen, Felix M. Simon, Philip N. Howard, and Rasmus Kleis Nielsen, “Types, Sources, and Claims of COVID-19 Misinformation, Reuters Institute for the Study of Journalism, April 2020

Md Saiful Islam; Tonmoy Sarkar, et al. “COVID-19–Related Infodemic and Its Impact on Public Health: A Global Social Media Analysis”,. *The American Journal of Tropical Medicine and Hygiene*, 10 August 2020

Spring, Marianna. 2020. “Koronavirus: The human cost of virus misinformation”, 2020.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Cela, Erlis

Covid-19 : Adresimi i ndikimit të dezinformacioneve dhe teorive konspirative përmes edukimit mbi median dhe informacionin / Erlis Cela. – Tiranë : Instituti Shqiptar i Medias, 2021
74 f. ; 14x20.5 cm.

ISBN 978-9928-4695-0-2

1.Masmedia 2.COVID-19 3.Informacioni
4.Propaganda publike 5.Shqipëri

659.2(496.5) :616 -036.21



ISBN 978-9928-4695-0-2



9 789928 469502 >